



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

## **NË**

### **INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

**Me objekt: “Mbi Përputhshmërinë e aktivitetit ekonomik dhe financiar”**

Auditimi i përputhshmërisë, është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 508/1, datë 15.05.2017, dhe ndryshimet e bëra me shkresën 508/2, datë 19.06.2017 dhe nr. 508/3, datë 21.06.2017, Periudha e audituar 01.07.2014 deri më 30.06.2017.

Auditimi është kryer nga:

- 1.Mimoza Lloji, përgjegjëse grupi;
2. Almida Kafia, anëtar;
3. Elisa Metaj, anëtar;
4. Erion Muho, anëtar;

Auditimi ka filluar më datë 15.05.2017

Auditimi ka përfunduar më datë 30.06.2017

**Korrik 2017**

**PËRMBAJTJA**

	PËRMBAJTJA	
I.	Përmbledhje	4
II	Hyrje	4
III	Qëllimi dhe procesi i auditimit	5-7
IV	Rezultatet e auditimit:	7-60
	<b>1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi I mëparshëm.</b> - Programet e hartuara nga subjekti për zbatimin e rekomandimeve. - Realizimi i tyre.	7-8
	<b>2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</b> - Mjedisi i kontrollit, - Menaxhimi i riskut, - Aktivitetet e kontrollit, - Informim komunikimi, - Monitorimi.	8-13
	<b>3. Auditimi i llogarive vitet 2014, 2015, 2016.</b> - Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.26, datë 27.12.2007. - Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rekomandimi me pasqyrat e tjera financiare.	13-34
	<b>4. Auditimi i zonave të llogarisë.</b> <b>4.1. Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe Sigurime Shoqërore (llog.601).</b> - Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave. - Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. - Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. - Realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %) dhe krahasimi me vitet e kaluara. - Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj. <b>4. 2. Mallra dhe shërbime (llog. 602).</b>	34-44



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

	<p>-Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë.</li><li>- Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën.</li></ul> <p><b>4. 3. Shpenzime për investime (llog. 230 dhe 231).</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimet e fondeve publike.</li><li>- Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i kontrolluar.</li><li>- Argumentimi dhe përlllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra punë e shërbime.</li><li>- Paraqitja në Agjencinë e Prokurimit Publik e statistikave për planifikimin dhe realizimin e prokurimeve</li><li>- Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.</li><li>- Kontroll i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve e shërbimeve.</li></ul> <p><b>5. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave.</b></p> <p><b>5.1. Të ardhurat nga buxheti i shtetit.</b></p> <p><b>a.</b> Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 6 mujori i parë 2017, në mbështetje të udhëzimeve të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit.</p> <p><b>b.</b> Zbatimi i kriterëve për çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimit të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në mbështetje të dispozitave ligjore e nënligjore.</p> <p><b>c.</b> Zbatimi i buxhetit të shtetit për vitin 2014, 2015, 2016, dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.</p> <p><b>5. 2. Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave detyësore nga veprimtaria ekonomike bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.</b></p> <p><b>a.</b> Burimi i krijimit të të ardhurave.</p> <p><b>b.</b> Mbledhja e të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore.</p> <p><b>c.</b> Respektimi i ndarjes së tyre sipas raporteve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët me Ministrinë e Financave.</p> <p><b>d.</b> Auditimi i përdorimit të të ardhurave nga institucioni.</p> <p><b>e.</b> Krahasimi analitik i tyre.</p> <p><b>7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.</b></p>	44-60
IV.	Konkluzionet dhe rekomandimet	60-64



## **I. Permbledhje**

Përgatitur me datë 30.06.2017 nga përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit Mimoza Lloji, Almida Kafia, Elisa Metaj dhe Erjon Muho, në Institucionin e Presidentit të Republikës, përfaqësuar nga z. Florian Nuri, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, mbi auditimin e ushtruar me objekt: *“Mbi përputhshmërinë e aktivitetit ekonomik dhe financiar”*.

Auditimi u krye bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 23.12.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, nga data 15.05.2017 deri më 30.06.2017, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit nr. 508/1, datë 15.05.2017, me ndryshimet e bëra me shkresën 508/2, datë 19.06.2017 dhe nr. 508/3, datë 21.06.2017 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjatë ushtrimit të auditimit, i cili përfshin periudhën nga data 01.07.2014 deri më datën 30.06.2017 dhe formulimit të këtij projektraporti, grupi i auditimit ka zbatuar *Kodin Etik dhe standardet e miratuara të kontrollit*.

Në përfundim të auditimit me personat përkatës përgjegjës në Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë u bënë ballafaqimet për gjetjet nga auditimi, dhe pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e këtyre punonjësve, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, dhe u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

*Në përfundim, mund të themi se Institucioni i Presidentit të Republikës ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, ka administruar përgjithësisht drejt vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion, bazuar në rregullat buxhetore.*

*Raportimet financiare paraqesin drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë të gjithë informacionin e nevojshëm për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm ka funksionuar përgjithësisht drejt evidentohet nevoja për përmirësime, sidomos në drejtim të forcimit të rregullaritetit financiar, të trajtuara sipas gjetjeve nga auditimi.*

## **II. Hyrje**

Për arritjen e objektivave, u përdor metoda e auditimit bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme. Testimi u bë në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme.

Në fazën e planifikimit parashikuam që zonat me risk ndodhen tek përdorimi i fondeve për investime por, nisur nga fakti që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon mirë, dhe se për periudhën objekt auditimi janë përdorur pak fonde për investime, risku është i nivelit të ulët.

Gjithashtu, për tu siguruar që fondet buxhetore janë të plota dhe të vlefshme, si dhe për të parë nëse veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, janë të plota dhe të regjistruara, u audituan zonat e llogarisë 600 “Pagat”, 601 “Sigurimet shoqërore”, 602 “Mallra e shërbime”, 604 “Të tjera transferata korrente të brendshme”, 606 “Transferata për buxhetet familjare dhe individët”, 230 dhe 231 “Shpenzime kapitale”, zona e të ardhurave dhe tregues të tjerë financiar.

Konstatohet se në Institucionin e Presidentit të Republikës nuk ekziston struktura apo punonjës të Auditimit të Brendshëm.

*Institucioni i Presidentit të Republikës mbështet aktivitetin e tij në aktet ligjore e nënligjore si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Rregullore e Brendshme për organizmin dhe funksionimin e Institucionit të Presidentit të Republikës, miratuar me Vendimin e Presidentit nr. 230/1, datë 2.02.2011.

*Veprimtaria financiare zhvillohet në përputhje me:*

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligji nr.185/2013 datë 2.12.2013 ” Për buxhetin e vitit 2014”
- Ligji nr.160/2014 datë 27.11.2013 ” Për buxhetin e vitit 2015”
- Ligji nr.147/2015 datë 17.12.2015 ” Për buxhetin e vitit 2016”
- Ligji nr.130/2016 datë 15.12.2016 ” Për buxhetin e vitit 2017”
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, indryshuar.
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar
- Ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjin nr.10383, datë24.2.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8097, datë21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare tëpersonave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.
- Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera tëpavarura, të krijuara me ligj, i ndryshuar.
- Vendimin i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dheadministrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.
- UMF nr.30.darë 27.12.2011”Për menaxhimin e e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
- Akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre, etj.

### **III. Qëllimi dhe procesi i auditimit**

Për arritjen e objektivave të auditimit, jemi bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit për të kuptuar specifikat e institucionit, sesi funksiononte sistemi i kontrollit të brendshëm. Pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, gjatë ushtrimit të auditimit të përputhshmërisë për zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullatore në veprimtarinë ekonomiko financiare, u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme.

Gjatë auditimit u konstatua se:

- Në Rregulloren e Brendshme në fuqi, parashikohen raportet punëdhënës-punëmarrës si dhe ato midis vetë punëmarrësve. Kodi i Etikës është pjesë përbërëse e rregullores.

Gjithashtu me Vendimin nr. 197, datë 07.02.2008 “*Mbi rregulloren për parandalimin e funksioneve publike në Institucionin e Presidentit të Republikës*”, është miratuar rregullorja për konfliktin e interesit.

- Përsa i përket integritetit personal dhe etikës profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të këtij Institucioni theksojmë se ai ka funksionuar sipas Rregullores së Brendshme e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit.

- Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për periudhën e viteve objekt auditimi (vitet 2014, 2015 dhe 2016) u konstatua se, sektori i financës, gjatë periudhës së auditimit nuk kishte të përfunduar zyrtarizimin e regjistrimit analitik të aktiveve sipas formatit zyrtar, në formë analitike, në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

- Në pasqyrat financiare për vitet 2014, 2015, 2016, mungonte formati 10 “Shënime shpjeguese”. Referuar SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

zberthim të mëtejshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese duhet të japi informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit dhe zërat jomateriale që mund të paraqiten të grupuar.

-Në gjendjen e inventarëve të Institucionit për vitet 2015 dhe 2016, konstatohet se pjesë e këtyre inventareve ishin dhe materiale shumë të konsumuara apo dëmtuara, për të cilat kosto e mbajtjes rezulton më e lartë se përfitimi nga përdorimi, të cilat janë vlerësuar mallra për nxjerrje jashtë përdorimit. Mbajtja e aktiveve të konsumuara dhe të papërdorshme nga ana e subjektit bën që Pasqyrat Financiare të mos paraqesin gjendjen reale, çka bie ndesh me parimet e hartimit të Pasqyrave Financiare.

Praktika e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit ka filluar të zbatohet në vitin 2017. Me Urdhrin nr.263 prot, datë 07.02.2017 është krijuar komisioni për vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe me Urdhërin nr.264 prot, datë 07.02.2017 është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre aktiveve. Nga auditimi rezultoi se procesverbali i vlerësimit të aktiveve nuk është firmosur nga nënpunësi autorizues, në kundërshtim me pikën 105 të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

- Nga auditimi i kryer mbi pasqyrat financiare të Institucionit të Presidentit të Republikës, konstatohet se lidhur me procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive, përmbajtjes dhe plotësimit të pasqyrave financiare është operuar në përputhje Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14 datë 28/12/2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit e zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26 datë 27.12.2007. Por përse i përket formatit 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” konstatohen disa anomali jomateriale, në hartimin e tij. Formatit 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” klasa II. Llogaria “Shpenzime për investime” duhet të rakordojë me formatin 6 “*gjendje dhe ndryshim i aktiveve të qendrueshme të trupëzuara*”.

-Nga auditimi u konstatua se, për periudhën e audituar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) është ngritur me urdhër nr.880 datë 31.03.2017.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) është ngritur me urdhër nr.880 datë 31.03.2017. Ekipit i Menaxhimit të Programeve (EMP), është ngritur për vitin 2014 me Urdhërin nr. 11, datë 07.04.2014, për vitin 2015 dhe 2016 me Urdhërin nr. 6, datë 16.04.2015 dhe për vitin 2017 me Urdhërin nr. 881, datë 31.04.2017. Për këtë periudhë nuk është operuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012 dhe nr. 22, datë 17.11.2016, ku theksohet rëndësia e EMP, ashtu sikundër dhe e GMS, në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor me qëllim realizimin e objektivave të synuara, të produkteve të parashikuara si dhe për përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit.

-Për periudhën objekt auditimi Institucioni i Presidentit të Republikës, ka krijuar të ardhura dytësore si rezultat i dhënies me qira të një ambienti brenda institucionit me sipërfaqe 50.4 m<sup>2</sup> së bashku me pajisjet, me destinacion Bar-Kafe, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.6.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, pika /b, në *vlerën 466,380 lekë*.

Konstatohet se, në kontratën vjetore të lidhur midis palëve, për cdo vit kalendarik, në nenin 7 “Të drejtat dhe detyrimet e qerramarrësit”, nuk është përcaktuar pagesa e shpenzimeve që do të kryejë qiramarrësi për energjinë elektrike dhe ujin e konsumuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit.

- Nga auditimi i kryer në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike dhe procedurat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla, bazuar në dokumentacionin u konstatua se, në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e legjislacionit mbi prokurimin publik/





## REZULTATET E AUDITIMIT.

### *IV.1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 846/6, datë 23.12.2014.*

KLSH ka audituar Institucionin e Presidentit të Republikës mbi ushtrimin e veprimtarisë ekonomiko financiare për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 30.06.2014. Me shkresën nr. 846/6, datë 23.12.2014, bashkëlidhur raportit Përfundimtar të auditimit, për përmirësimin e gjendjes së institucionit, janë rekomanduar tetë (tetë) masa organizative.

Në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve Institucioni i Presidentit të Republikës, i ka kthyer përgjigje KLSH-së, me shkresën nr.1584/6, datë 12.01.2015, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 8 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 7 rekomandime, nuk është pranuar një rekomandim. Nga rekomandimet e pranuar 4 janë zbatuar plotësisht, 2 janë të pazbatuar dhe 1 rekomandim i zbatuar pjesërisht.*

Në mënyrë të detajuar nuk janë zbatuar rekomandimet nr.2 dhe 4 dërguar me shkresën 846/6, datë 23.12.2014.

**Rekomandimi nr.2** Nga auditimi i zonave të llogarisë mbi respektimin e strukturës organike për periudhën objekt auditimi, u konstatua se, Administrata e Institucionit të Presidentit të Republikës, ka punuar dhe vazhdon të punojë me Rregulloren e Brendshme të miratuar me Vendimin e Presidentit nr. 230/1, datë 02.02.2011, ndërkohë që struktura organike ka ndryshuar disa herë dhe së fundi është në fuqi struktura e miratuar me Vendimin nr. 299, datë 07.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”,

***Për sa më sipër është rekomanduar:***

Institucioni i Presidentit të Republikës të marrë masa për miratimin e Rregullore së re, për organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të gjejnë zbatim detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe të reflektohen ndryshimet strukturore të bërë deri tani.

***Brenda datës 31.3.2015***

***Përgjigja e subjektit:***

Institucioni nuk ka miratuar Rregullore të re, për organizimin dhe funksionimin e institucionit, ku të reflektohen ndryshimet strukturore të bëra deri më tani, por ka ushtruar aktivitetin edhe për periudhën 01.07.2014 deri më 30.04.2017 me rregulloren e miratuar me Vendimin e Presidentit nr. 230/1, datë 02.02.2011.

***Komenti***

***Për sa më sipër ky rekomandim është pranuar dhe konsiderohet pa realizuar.***

**Rekomandimi nr. 4.** Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë rezultoi se, pavarësisht se, shumica e mjeteve monetare të përdorura nëpërmjet arkës së lekë është e vogël, institucioni nuk ka miratuar limitin ditor të arkës në lekë, në përputhje me pikën 63, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

***Për sa më sipër është rekomanduar:***



Institucioni i Presidentit të marrë masat e duhura që në përputhje me nevojat më të domosdoshme që ka për mjete monetare në lekë, të bëjë propozimin përkatës pranë Nënpunësit të parë autorizues për miratimin e limit ditor të arkës.

*Menjëherë*

Përgjigja e subjektit:

Institucioni me shkresën nr. 788, datë 10.04.2015, i ka kërkuar Ministrisë së Financave të miratojë limitin mujor të arkës. Ministria e Financave, me shkresën nr. 5612/1, datë 06.05.2015, nuk ka konfirmuar miratimin e limitit, me argumentimin se Institucioni i Presidentit nuk disponon akte të vecanta specifike.

Komenti

*Për sa më sipër ky rekomandim është pranuar nga Institucioni por konsiderohet i pa zbatuar për shkak të përgjigjes së Nënpunësit të Parë Autorizues.*

**IV.2. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit**

*Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në bazë të këtij ligji u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Institucionin e Presidentit të Republikës.*

Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Objektivi i veprimtarisë së Institucionin e Presidentit të Republikës është:

- Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit të Republikës, nëpërmjet dekretimeve të ligjeve, dekretimeve për shtetësinë dhe dekorata e tituj nderi.
- Njohja e vlerave kombëtare dhe synimet e politikës së jashtme të vendit, nëpërmjet shkëmbimit të vizitave të Presidentit të Republikës dhe pritjes së personaliteteve të larta shtetërore.
- Mbështetja dhe nxitja e vlerave kombëtare, si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit, nëpërmjet organizimit të veprimtarive protokollare brenda vendit.

Institucioni i Presidentit të Republikës ka funksionuar dhe funksionon në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Brendshme, e cila është miratuar me Vendimin e Presidentit nr. 230/1, datë 02.02.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Presidentit të Republikës”. Për përmbushjen e misionit të tij, Institucioni i Presidentit, ka hartuar deklaratën e misionit të njësisë në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, e konkretisht për vitin 2016, ka hartuar projektbuxhetin, duke përcjellë pranë Ministrisë së Financave pasqyrat e kërkesave buxhetore për vitet 2017-2019, me shkresën nr.42/1, datë 29.04.2016 dhe me shkresën nr.1497./1 datë 25.08.2016. Si dhe për vitin 2017 me shkresën nr. 513/1, datë 28.04.2017 janë përcjellë pranë Ministrisë së Financave pasqyrat e kërkesave buxhetore për vitet 2018-2020.

- Grupi i auditimit konstatoi se, mbështetur në ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, neni 18, pika 1 i cili citon se ..... “Nënpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë





se fundi i muajit shkurt aktual” Institucioni i Presidentit të Republikës, ka depozituar deklaratën apo raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm së bashku me pyetëtorin e vetëvlerësimit shkresërisht si më poshtë vijon: për vitin 2014 me shkresën nr.2379/1 datë 27.02.2015; për vitin 2015 me shkresën nr.2156/1 datë 26.02.2016 dhe për vitin 2016 me shkresën nr. 369 datë 21.02.2017.

- Gjithashtu konstatohet se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a, nuk është hartuar dhe propozuar plani strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, pavarësisht miratimit të nisjes së këtij procesi me Urdhër nr. 1504 datë 18.7.2012 të Sekretarit të Përgjithshëm ende nuk ka filluar të zbatohet ky Urdhër. Për pasojë nuk mund të kemi siguri të arsyeshme nëse punonjësit e njësisë publike janë njohur me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Nga vetë natyra institucioni nuk ka struktura varësie.

Institucioni ka përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011. Pra, është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresimi i personat përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konformë përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Me Urdhër të Brendshëm nr.880 datë 31.03.2017 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), sipas nenit 27 të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe sipas kreut IV pika 4.2.9 të manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhër nr. 8990 datë 15.07.2010 të Ministrit të Financave, ku citohet se “Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. Grupi për Menaxhimin Strategjik është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike”.GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljen etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për Titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

-Është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve, detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të titullarit të institucionit, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji. Pra si rrjedhojë dhe në përputhje me nenin 21, pika 2: “Menaxhimi i riskut”: ku citohet: “Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, (ose duke deleguar këtë detyrë) miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”.

Në kreun III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, citohet: “Titullarët e njësisë të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi. Mbështetur në përgjigjet e pyetësorit, nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi mbi komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### 1. Mjedisi i kontrollit.

Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a, nuk është hartuar dhe propozuar plani strategjik pavarësisht nxjerrjes së Urdhërit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 1504, datë 18.7.2012. Për pasojë nuk mund të kemi siguri të arsyeshme nëse punonjësit e njësisë publike janë njohur me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Institucioni ka funksionuar sipas Rregullores së Brendshme e cila përcakton rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit. Kjo rregullore është miratuar nga Presidenti me Vendimin nr. 230/1, datë 02.02.2011. Por në këtë rregullore nuk janë pasqyruar detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe prej institucionit është hartuar një draft rregullore e re e cila do të marr në konsideratë përshtatjen me ligjin e sipërcituar, por deri në përfundim të periudhës së auditimit kjo draft rregullore nuk ka marr formë zyrtare.

Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, thuhet se, punonjësit duhet të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, dhe në institucion Kodi i Etikës është pjesë përbërëse e rregullores së brendshme.

Me Vendimin nr. 197, datë 07.02.2008 “Mbi rregulloren për parandalimin e funksioneve publike në Institucionin e Presidentit të Republikës”, është miratuar rregullorja për konfliktin e interesit.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Për periudhën 01.01.2016-30.04.2017, njësia ka funksionuar dhe është e organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhërin e Presidentit nr. 237, datë 09.12.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”.

Ndërkohë për vitin 2014 ka qenë në fuqi Vendimi nr. 29 datë 07.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”, në 05.11.2014 me Vendim nr. 314 është miratuar struktura e re e cila është rishikuar me Vendimin nr. 308 datë 11.09.2014. Për vitin 2015 kanë dal tre vendime të tjera në lidhje me strukturën dhe organikën e institucionit, konkretisht Vendimi nr. 321 datë 28.01.2015; Vendim nr. 327 datë 17.02.2015 dhe Vendimi nr. 332 datë 26.11.2015.

Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar numrin e punonjësve gjithsej, pozicionin e vendit të punës si dhe kategorinë për çdo pozicion. Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësive dhe të kalimit të informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga Sekretari i Përgjithshëm deri tek specialistët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimarrje. Sekretari i Përgjithshëm është dhe nëpunësi autorizues i njësisë. Sipas strukturës së njësisë, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Menaxhimit është nëpunësi zbatues dhe përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor me synim arritjen e qëllimeve dhe politikave të programit, ndërkohë që firmë



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

e dytë si nëpunës zbatues, është shefi i sektorit të financës. Drejtorët apo përgjegjësit e sektorëve janë në varësi direkte të nëpunësit autorizues. Ndryshimet e strukturës organike të institucionit priten të reflektohet edhe në rregulloren e brendshme të institucionit që po shqyrtohet nga strukturat vendimmarrëse.

Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin”.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin në Institucionin e Presidentit të Republikës rregullohen në bazë të Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil dhe Kodin e Punës. Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, Kodi i Punës dhe dispozitat e tjera ligjore si, ligji për buxhetin e shtetit, ligji për prokurimin publik, kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, etj, lejojnë titullarin e institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave të ndërmarrë hapat e duhura. Bazuar në nenin 15 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Presidentit të Republikës” të miratuar me Vendimin e Presidentit të Republikës nr. 230/1, datë 02.02.2011, Sekretari i Përgjithshëm delegon me shkrim kompetencat në bazë të rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, duke përcaktuar një organ tjetër brenda institucionit. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo drejtuesit.

Lidhur me delegimin e kompetencave, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues dhe punonjës të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, sikundër kërkohet nga ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Konkretisht Urdhër nr.1 datë 29.05.2008 “Mbi administrimin e akteve dhe dokumentacionit në Institucionin e Presidentit të Republikës”, si dhe shkresa nr. 16824/1 datë 12.12.2014 e Ministrisë së Financave.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e Institucionit për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Janë kryer vlerësimet vjetore të punës për çdo punonjës, të cilat i janë bashkëlidhur dosjes së gjithsecilit, këto vlerësime janë të protokolluara sipas akteve ligjore.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia në bashkëpunim dhe nën drejtimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike ka trajnuar punonjësit e saj, por vetë sektori i burimeve njerëzore nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve apo një plan vjetor trajnimesh për punonjësit e administratës, sikundër kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafet “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

2. Menaxhimi i riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, Institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, si dhe nenit 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 specifikohet se koordinatori i riskut, duhet të jetë Nënpunësi Autorizues, ose kjo detyrë të delegohet. Për vitin 2016 me Urdhër të Brendshëm nr.9, datë 21.04.2016 është deleguar detyra e koordinatorit të riskut tek nënpunësi zbatues i dytë.

Për menaxhimin e riskut Institucioni pas planifikimit të fondeve buxhetore ndjek hap pas hapi realizimin e treguesve buxhetore nën drejtimin e koordinatorit të riskut, si dhe ka një strategji risku të dokumentuar dhe të miratuar me Urdhër nr.1368 datë 29.06.2016 “Për miratimin e strategjisë së riskut në Institucionin e Presidentit”.

#### 3. Aktivitetet e kontrollit.

Proceset kryesore të punës operationale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston ndarja e detyrave. Nënpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare në këtë institucion kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave. Institucioni, ka të miratuar udhëzimin për gjurmën e auditimit dhe të prokurimeve sipas përcaktimeve të pikës 121 të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 dhe urdhërit nr. 92, dt. 29.12.2011 të Ministrit të Financave “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”. Në strukturën e institucionit ekziston dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit i cili bën të mundur kontrollin e sistemit të IT-së. Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit kompjuterik “Financa 5”.

#### 4. Informim komunikimi.

Drejtnesit e institucionit zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, janë njohur me Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Sekretari i Përgjithshëm informohet rregullisht nga Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit me anë të situacione buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, si dhe me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-muaj dhe ky informacion që merret nga nëpunësi zbatues është i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Sekretarit të Përgjithshëm.

Në Institucionin e Presidentit të Republikës sistemi i IT-së, ofron informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në terësi dhe të strukturave të veçanta të saj. Për një komunikim sa më të përshtatshëm brenda njësisë, Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhrin nr.1, datë 29.05.2008 “Mbi administrimin e akteve dhe dokumentacionit në Institucionin e Presidentit të Republikës”, i ndryshuar me Urdhër nr.10 datë 31.03.2014. Në këtë urdhër përcaktohen qartë rregullat për përgatitjen, qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit që hyn dhe del nga Institucioni i Presidentit dhe dokumentacionin që qarkullon brenda institucionit, në përmbushje të detyrave funksionale të strukturave përkatëse.

Për mbledhjen e ankesave të jashtme dhe analizën e tyre, Presidenti i Republikës me Vendimin nr. 211, datë 09.12.2008, ka miratuar rregulloren për të drejtën e informimit dhe trajtimit të kërkesave dhe ankesave të ardhura nga publiku në adresë të Presidentit të Republikës.

Sistemi i IT-së, garanton për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) dhe ripërfitimin e të dhënave, në rast aksidenti. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

#### 5. Monitorimi.

Në këtë Institucion Sekretari i Përgjithshëm informohet vazhdimisht nga drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve, mujore dhe tremujore.

Institucioni i Presidentit të Republikës nuk ka strukturë të auditit të brendshëm por është audituar vazhdimisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.



#### **IV. 3. Auditimi i llogarive vitet 2014, 2015, 2016.**

Auditimi u ushtrua në drejtim të hartimit të pasqyrave financiare nga pikëpamja formale dhe logjike e plotësimit të tyre si dhe respektimi i afateve në dorëzimin e llogarive vjetore të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Nga auditimi i llogarive për vitet 2014, 2015 dhe 2016 rezultoi se pasqyrat financiare të përgatitura nga njësia publike janë:

- bilanci kontabël (aktivi dhe pasivi sipas formateve nr.1 e nr.2);
- pasqyra e shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit ( formatet nr. 3/1 e 3/2);
- burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (formati nr.4);
- pasqyra mbi lëvizjen “CASH”(formati nr.5);
- pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet ne Aktivet e Qendrushme si dhe amortizimin e tyre (formatet nr. 6 e nr. 7);
- pasqyra e lëvizjes së fondeve (formati nr. 8);
- pasqyra mbi numrin e punonjesve dhe fondin e pagave (formati nr. 9).

Bilanci Kontabël është shoqëruar me relacionin përkatës bashkëlidhur pasqyrave financiare.

#### ***Mbi hartimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportimi i tyre.***

Pasqyrat financiare për periudhën objekt auditimi, vitet 2014, 2015, dhe 2016 të hartuara nga Institucioni i Presidentit dhe të dorëzuara në Ministrinë e Financave janë të përgatitura në zbatim të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare” si dhe udhëzimeve të Ministrisë të Financave për mbylljen e llogarive vjetore. Auditimi është ushtruar në lidhje me zbatueshmërinë e kuadrit rregullator për përgatitjen e tyre. Nga subjekti janë vënë në dispozicion në format hard copy pasqyrat financiare të dorëzuara në Drejtorinë e Kontabilitetit, Ministrinë e Financave. Nga analiza paraprake e saktësisë së shumave të paraqitura në këto pasqyra dhe vendosjes së vlerave në llogari është vlerësuar se përgjithësisht është vepruar drejt. Në vazhdim janë kërkuar të dhëna subjektivit në lidhje me llogari të ndryshme për të verifikuar paraprakisht shumat dhe pasqyrat financiare të tre viteve. Institucioni i Presidentit për hartimin e pasqyrave financiare bën kontabilizimin e dokumentacionit nëpërmjet programit kompjuterik Financa 5.

Informacioni nga pasqyrat financiare të Institucionit të Presidentit të Republikës, për të tre vitet ushtrimorë të njëpasnjëshëm 2014, 2015 dhe 2016 rezulton si më poshtë:

#### ***Për vitin 2014***

Për këtë vit ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Sektorit të Financës dhe Buxhetit. Mbas verifikimeve shifrat e rakorduara në të dy pozicionet, pra degë thesari & bankë, janë regjistruar dhe rakorduar në rregull.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2014 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Institucionin e Presidentit, është bërë në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë.

b. Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Ministrinë e Financave me shkresën nr.335 prot, datë 10.02.2015, konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2014 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formateve nr.1&2; Pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave (Formatet nr.3/1 & 3/2); Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr.4); Pasqyrën mbi lëvizjen “CASH” (Formati nr.5); Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme si dhe Amortizimin e tyre (Formati nr.6 &7); Pasqyrën e lëvizjes së fondeve (Formati nr.8); Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Pasqyra nr.9) si dhe Relacionin shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2014, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2014-2013), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Grupimi i llogarive te aktivitet	Ushtrimi per vitin		Pesha		Diferenca
	2014	2013	2014	2013	
Aktive te Qëndrueshme	368,581,425	391,976,947	93%	91%	-23,395,522
Aktive Qarkulluese	29,232,724	38,520,996	7%	9%	-9,288,272
Llogari te tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktivitet</b>	<b>397,814,150</b>	<b>430,497,943</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>-32,683,793</b>

Nga auditimi u konstatua se përsa i përket totalit të aktiveve nga viti 2013 në vitin 2014 konstatohet një trend rënës si vijon: Aktivet e Qëndrueshme kanë zënë 91% të totalit të Aktivitet (ose rreth 392 mijë lekë) dhe Aktivet Qarkulluese zinin 9% të totalit (ose rreth 38 mijë lekë). Gjatë vitit 2014 ky raport ka ndryshuar me trend rënës për Aktivet e Qëndrueshme, të cilat kanë zënë 93% të totalit të Aktivitet (ose rreth 369 mijë lekë); me një rënie prej 23,395,522 lekë krahasuar me një vit më parë. Dhe Aktivet Qarkulluese zënë 7% të totalit të aktiveve (ose rreth 29 mijë lekë), konkretisht me një rënie prej 9,288,272lekë krahasuar me 2013.

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Celja në fund të vitit 2013	Shtesa gjatë vitit 2014	Pakësime gjatë vitit 2014	Gjendja në mbyllje, viti 2014	Ndryshimi
<b>Aktive të trupëzuara</b>					
Ndërtim edhe konstruksione	347,576,835	746,892	-	348,323,727	746,892
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	20,360,489	912,480	474,920	20,798,049	437,560
Mjete transporti	72,708,450	-	-	72,708,450	0
Inventar Ekonomik	163,398,315	3,022,726	6,197,684	160,223,357	(3,174,958)
<b>Totali</b>	<b>604,044,089</b>	<b>4,682,098</b>	<b>6,672,604</b>	<b>613,626,708</b>	<b>602,053,583</b>

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej 57% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “Inventarit ekonomik” e cila zë një peshë prej 26% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara, llogaria “Mjete transporti” zë peshën prej 12% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara dhe është





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

mbartur e pa ndryshuar nga viti 2013. Llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” është shtuar nga viti shkuar dhe zë një peshë prej 3% të totalit të Aktiveve të Qëndrueshme.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2014, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2014-2013), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2014	2013	Diferenca 2014 – 2013
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QENDRUESHME</b>	<b>368,581,425</b>	<b>391,976,947</b>	<b>(23,395,522)</b>
<b>21,23,24,28</b>	<b>II. Aktive Të Qendrueshme Të Trupëzuara</b>	<b>368,581,425</b>	<b>391,976,947</b>	<b>(23,395,522)</b>
212	Ndërtime e Konstruksione	348,323,727	347,576,835	746,892
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	20,798,049	20,360,489	437,560
215	Mjete transporti	72,708,450	72,708,450	0
218	Inventar Ekonomik	160,223,357	163,398,315	(3,174,958)
219	Amortizim AQT	(233,472,158)	(212,067,142)	(21,405,016)
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>29,232,724</b>	<b>38,520,996</b>	<b>(9,288,272)</b>
Klasa 3	Gjendja e Inventarit	15,280,203	13,112,606	2,167,597
31	Materiale	12,045,475	9,812,427	2,233,048
32	Objekte inventari	3,234,728	3,300,179	(65,451)
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>13,847,061</b>	<b>24,642,390</b>	<b>(10,795,329)</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin	13,847,061	24,642,390	(10,795,329)
<b>50.59</b>	<b>III.Llogaritë financiare</b>	<b>105,460</b>	<b>766,000</b>	<b>(660,540)</b>
520	Disponibilitete në thesar	105,460	766,000	(660,540)
	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>397,814,149</b>	<b>430,497,943</b>	<b>(32,683,794)</b>

Aktive Të Qëndrueshme paraqitet për 368,581,425 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara” plus Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që kap shumën 368,581,425 lekë, e cila ka dalë si diferencë midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 233,472,158 lekë.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë e grupit 212,214,215,218,219:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” gjatë vitit ka pësuar shtim në vlerën 746,892 lekë për shkak të rikostruksionit të rrethimit të Institucionit.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 20,798,049 lekë, shtuar nga viti shkuar me 437,560 lekë për shkak të blerjes së kondicionerëve me vlerë 793,200 lekë dhe korrëse bari me vlerë 119,280 lekë, si edhe pakësuar për 474,920 lekë prej daljes jashtë përdorimit të disa pajisjeve për montazhin, pajisje audio-vizuale, kamera, pajisje të oficinës etj.

Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 72,708,450 lekë e mbartur e pa ndryshuar nga viti 2013 përfaqëson vlerën e mjeteve të transportit të Institucionit.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 160,223,357 lekë dhe është pakësuar me 3,174,958 lekë nga të cilat 3,022,726 lekë janë shtesa për shkak të blerjes me pagesë të kolltuqeve, tavolinave, kasaforta etj. dhe 6,197,684 lekë janë nxjerrje jashtë përdorimit të kompjuterave, printera, karrike etj. Si dhe amortizimi i aktive të qëndrueshme me vlerën 233,472,158 lekë.

Aktive Qarkulluese paraqiten më vlerën 29,232,724 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë:

Gjendja e inventarit paraqitet në shumën 15,280,203 lekë, duke pësuar një shtim prej vitit të kaluar 2013 me 2,167,597 lekë. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën përkatëse 3/1 llogaritë debitore. Në përbërje të kësaj llogarie janë llogaria 31 “Materiale” e cila në fund të vitit pasqyrohet me vlerën 12,045,475 lekë, me një shtim prej 2,233,048 lekë nga viti shkuar, i cili përfaqëson blerje të materialeve të pastrimit e kancelerie, si dhe llogaria 32 “Objekte inventari” me vlerën prej 3,646,508 lekë e cila përfaqëson blerjen e inventarit të imët dhe është pakësuar nga viti kaluar me 65,451 lekë, pakësim i shkaktuar nga nxjerja jashtë përdorimit të inventarit përkatës.

Kërkesa arkëtimi mbi debitorët paraqitet në shumën 13,847,061 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin” përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2014, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detyrimet ndaj furnitorëve për blerjet e bëra dhe kreditorëve për shërbimet e kryera, të cilat për këtë vit janë më pak se në vitin 2013. I gjithë ky zë është pakësuar me 10,795,329 lekë si rrjedhojë e patjes së më pak aktiviteteve se një vit më parë, e për rrjedhojë më pak shërbime.

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 105,460 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë 105,460 lekë vlerë e cila është pakësuar prej vitit 2013 me 660,540 lekë, dhe përfaqëson sponsorizimin e mbetur nga vlera e dy kontratave, pasi është zbritur përdorimi sipas urdhër shpenzimit. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF procedurat e mbylljes së llogarive, Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme. Teprica në këtë llogari vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin, ku paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve).

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2014, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave vitit 2014 me vitin 2013, rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2014	2013	Diferenca 2014 – 2013
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>383,861,628</b>	<b>405,089,553</b>	<b>(21,227,925)</b>
101	Fonde bazë	383,861,628	405,089,553	(21,227,925)
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>13,847,061</b>	<b>24,642,390</b>	<b>(10,795,329)</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>Detyrime afatshkurtër</b>	<b>13,847,061</b>	<b>24,642,390</b>	<b>(10,795,329)</b>
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	1,488,950	3,732,800	(2,243,850)
42	Personeli e llogari të lidhura me to	5,511,450	5,511,450	0
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	651,283	651,741	(458)
435	Sigurime shoqërore	1,565,452	1,512,090	53,362
436	Sigurime shëndetsore	234,644	187,543	47,101



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

466	Kreditorë për mjete në ruajtje	0	0	0
467	Kreditorë të ndryshëm	4,395,282	13,407,148	(9,011,866)
85	Rezultati i ushtrimit	105,460	766,000	(660,540)
<b>X</b>	<b>TOTALI I PASIVIT (A+B)</b>	<b>397,814,149</b>	<b>430,497,943</b>	<b>(32,683,794)</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezultojnë llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 32,683,794 lekë, ose 8% më pak, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101“Fonde bazë”, është pakësuar këtë vit me vlerën 21,227,925lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, pakësuar në vlerë nga 24,642,390 lekë një vit më parë, në 13,847,061 lekë, pra janë pakësuar këtë vit me shumën prej 10,795,329 lekë, si më poshtë:

Llogaria 401-408” Furnitore e llogari të lidhura me to” është pakësuar këtë vit me 2,243,850 lekë si rrjedhojë e paksimit të blerjeve të muajt dhjetor duke arrit në vlerën 1,488,950 lekë.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, nuk ka ndryshim me gjendjen e një viti më parë.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor 2014, edhe është pakësuar këtë vit me vlerën 458 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit me vlerën 53,362 lekë, duke arritur vlerën prej 1,565,452 lekë, si rrjedhojë e rritjes së tavanit mbi të cilën llogariten kontributet.

Llogaria 436“Sigurime shëndetësore”, është shtuar këtë vit me vlerën 47,101 lekë, duke arritur vlerën prej 234,644 lekë, si rrjedhojë e rritjes së tavanit mbi të cilën llogariten kontributet.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është pakësuar për 660,540 lekë, përfaqëson pjesën e mbetur të sponsorizimeve nga viti 2013, pasi është përdorur sipas kontratave.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 105,460 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit si rezultat i një sponsorizimi që ka kryer Banka Societe General Albania për “Ballon Shqiptare” në 21.12.2013 dhe nuk mund të përdoren për destinacion tjetër.

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogaritë vjetore të vitit 2014, janë plotësuar si më poshtë:

Formati 3/1“Shpenzimet e ushtrimit”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2014. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muajt dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2014 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2013.

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën 169,130,710 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzimeve personeli” për 79,353,908 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 11,364,687 lekë, llogaria 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për 78,723,074 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 1,386,150 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2014.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 3,157,420 lekë paraqet shumën e shpenzimeve specifike të Institucionit. Në këtë post janë vendosur gjithë shpenzimet që janë kryer për blerje të titujve, dekoratave dhe dhuratave.



- 6022 Shërbime për shumën 11,282,487 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje me roje civile.
- 6023 Shërbime transporti për shumën 11,830,220 lekë përfaqësojnë shpenzime për shërbimet e automjeteve të institucionit si naftë, vaj , pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 27,565,520 lekë përfaqësojnë shpenzimet që institucioni kryen për pagesën e dietave të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 3,125,020 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre dhe kryesisht mirëmbajtja e faqes së internetit, e rrjetit kompjuterik, riparimet e automjeteve të Presidentit dhe të administratës.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 20,376,257 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor por që janë të nevojshme të kryhen gjatë periudhës buxhetore.

Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme" për shumën 280,000 lekë përfaqëson llogarinë 6040 "transferime tek nivele të tjera të Qeverisë" dhe janë përfshirë transfertat për shpërbime të menjëhershme me fonde nga Ministria e Financës, për Këshilltarë apo Ndihmësa të Presidentit, në momentin e largimit nga puna (dy paga shpërblim).

Llogaria 606 "Transferita tek buxhetet familjare" mbështetje për raste fatkeqësish ku për këtë vit ka patur 3 raste të tilla dhe një rast ndihmë për sëmundje. Gjithashtu pjesë e pasqyrës 3/1 "shpenzime të ushtrimit" janë edhe llogaritë: llogaria 8421 "derdhje në buxhet e të ardhurave të papërdorura" përfshihen të ardhurat nga dhënia me qera e ambjentit të Institucionit për Bar-Kafe (116,500 lekë), ndërsa 1,536 lekë janë derdhje gabim në llogarinë e Institucionit nga subjekte private. Si dhe llogaria 8423 "transferim për ndryshim gjendje" që përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit, nga viti 2013 dhe pasqyrohet edhe në llogarinë 63.

Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën -2,167,597 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 85 "Rezultate nga funksionimi" prej përfaqëson diferencën pozitive midis totalit të operacioneve të të me totalin e operacioneve të shpenzimeve, në përputje me Udhëzimin 14 datë 28.12.006 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 "Saldo kreditore" e pasivitetit të pasqyrave financiare.

#### Formati 3/2 "Të ardhurat e ushtrimit"

Kjo pasqyrë paraqitet në shumën 171,21,803 lekë dhe është e rakorduar me pasqyrën nr.3/1 "Shpenzime të shfrytëzimit" "Llogaritë Debitore".

Të ardhurat e e Institucionit të Presidentit janë të karakterit "Të ardhura jo Tatimore" dhe kapin shumën 118,306 lekë nga të cilat: 116,500 lekë, lekë janë të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia dhe që konkretisht përfaqësojnë të ardhurat nga ambjenti me qera dhe krahasuar me 2013 janë shtuar me 34,065 lekë si rrjedhojë e shtimit të kohës së dhënies me qera, pasi në vitin 2013 është dhënë për një kohë më të shkurtër. Si dhe një shumë prej 1,536 lekë e cila përfaqëson tarifa administrative dhe rregullatore të derdhura gabimisht në llogarinë e Institucionit.

Njëkohësisht është edhe llogaria 72 "Grante Korrente" që paraqitet me shumën 171,403,767 lekë që përfshijnë llogarinë 720 "Grant korrent i brendshëm" të përbërë nga llogaria 7200 "Grant korrent i brendshëm nga i njëjti nivel qeverisje" për vlerën 156,581,246 lekë, shtuar nga viti kaluar me 35,850,959 lekë si rrjedhojë e shtimit të fondeve buxhetore dhe sipas argumentimit nga ana e institucionit përfaqëson shpenzimet korrente të korektuara pasi janë zbritur detyrimet për vitin e



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

ardhshëm dhe pjesa e sponsorizimit. Si dhe llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti“ me vlerën 13,847,061 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për tu paguar në vitin e ardhshëm dhe është pakësuar nga viti i shtuar me 10,795,329 lekë si rrjedhojë e pakësimit të detyrimeve ndaj furnitorëve dhe kreditorëve. Kjo llogaria pasqyron si kundërparti ato lloj shpenzimesh të konstatuara nga institucioni në vitin ushtriomor që përballohen me fondet e buxhetit të vitit të mëpasshëm (pagat, sigurimet shoqërore, shëndetsore dhe tatimet e muajit Dhjetor). Mbi bazën e këtij informacioni në fund të periudhës ushtrimore Institucioni ka kryer veprimin kontabël mes llogarive 4342 ”Marrdhënie me shtetin debitor” dhe 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”. Nga auditimi konstatohet se kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2014.

Formati nr.4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” kjo pasqyrë paraqet levizjet dhe tepricat e llogarive të shpenzimeve të lidhura me investimet. Përsa i përket formatit të kësaj pasqyre për Institucionin e Presidentit konstatohet se ajo përfaqëson burimet për investime të kryera gjatë vitit 2014 dhe është realizuar nga granti i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje për 4,682,096 lekë. Sa më sipër përfaqëson investimet me fonde buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave.

Formati nr.5 “Pasqyra e lëvizjes “Cash” për vitin 2014”, është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të regjistruar fondet buxhetore korrente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korrente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadruara nga dega e thesarit. Nga auditimi konstatohet se, “Teprica në mbyllje” rakordon me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.

Formati nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) 2014”, është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Nga auditimi konstatohet se, gjendjet në çelje dhe në mbyllje të ushtrimit për çdo kategori të aktiveve të qëndrueshme janë të barabarta me të dhënat e evidentuara për to në postet e aktiveve të qëndrueshme në aktiv të bilancit kontabël.

Në zërin shtesa janë përfshirë tre shuma për blerje të realizuara gjatë vitit për 4,682,098 lekë dhe janë dy shuma të tjera për nxjerrje jashtë përdorimit. Gjatë këtij viti janë ngrit komisionet për vlerësimin e afatgjata dhe afatshkurtra materiale me Urdhër të Brendshëm nr.33 datë 05.12.2014 si dhe komision për nxjerrjen jashtë përdorimit me Urdhër të Brendshëm nr. Mbështetur mbi këta urdhëra vlere e aktiveve të nxjerrja jashtë përdorimit në fund të vitit 2014 rezulton të jetë 6,987,455 lekë.

Për vitin 2014, Institucioni i Presidentit, bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe në Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave ka kryer inventarizimin e pasurisë së institucionit. Për këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhërin nr. 2392 prot, dt. 19.12.2014 për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve. Nëpërmjet tij u ngrit komision për inventarizimin dhe vlerësimin e vlerave materiale të zyrave dhe komision për inventarizimin e materialeve në magazinë dhe të automjeteve.

Formati nr.7 “Pasqyra e amortizimit vjetor”, pasqyra është plotësuar konform kërkesave të VKM nr.401 të vitit 1989 dhe shumat e kësaj pasqyre kanë korrespondencë me shumat e sistemuara në aktiv të bilancit.

Formati 8 Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në çelje dhe përfundim të ushtrimit të vitit 2014 ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime, rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim është kryer konform





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël. Gjendja në fund e saj është e barabartë me pasivin e bilancit, e kuadruar me fondin në total.

Formati nr.9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjate vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve. Numri i punonjësve për 2014 korrespondon me strukturën faktike.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën nr.3/1 Shpenzime të Shfrytëzimit, përjashton kollonën 8 të saj e cila ka 27.9% për Sigurimet Shoqërore.

Për vitin 2015

Edhe për këtë vit ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Sektorit të Financës dhe Buxhetit. Mbas verifikimeve shifrat e rakorduara në të dy pozicionet, pra degë thesari & bankë, janë regjistruar dhe rakorduar në rregull.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2015 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Institucionin e Presidentit, është bërë në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë.

b.Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, është përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë nr.400 prot, datë 23.02.2016, e konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2015 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formateve nr.1&2; Pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave (Formatet nr.3/1 & 3/2); Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr.4); Pasqyrën mbi lëvizjen “CASH” (Formati nr.5); Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme si dhe Amortizimin e tyre (Formati nr.6 & 7); Pasqyrën e lëvizjes së fondeve (Formati nr.8); Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Pasqyra nr.9).

#### **Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.**

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2015, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2014), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

Grupimi i llogarive te aktivit	Ushtrimi per vitin		Pesha		Diferenca
	2015	2014	2015	2014	
Aktive te Qëndrueshme	359,799,106	368,581,425	91%	93%	-8,782,319
Aktive Qarkulluese	36,177,265	29,232,724	9%	7%	6,944,541
Llogari te tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktivit</b>	<b>395,976,371</b>	<b>397,814,150</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>-1,837,779</b>

Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2014 Aktivet e Qëndrueshme kanë zënë 93% të totalit të Aktivit (ose rreth 369 mijë lekë) dhe Aktivet Qarkulluese zinin 7% të totalit (ose rreth 29 mijë





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

lekë). Gjatë vitit 2015 ky raport ka ndryshuar me trend rënës për Aktivet e Qëndrueshme, të cilat kanë zënë 91% të totalit të Aktivit (ose rreth 360 mijë lekë); me një rënie prej 8,782,319 lekë krahasuar me një vit më parë. Dhe Aktivet Qarkulluese zënë 7% të totalit të aktiveve (ose rreth 36 mijë lekë), konkretisht me një rritje prej 6,944,541 lekë krahasuar me 2015.

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Celja në fund të vitit 2014	Shtesa gjatë vitit 2015	Pakësime gjatë vitit 2015	Gjendja në mbyllje, viti 2015	Ndryshimi
<b>Aktive të trupëzuara</b>					
Ndërtim edhe konstruksione	348,323,727	6,922,025	-	355,245,752	6,922,025
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	20,798,049	540,000	-	21,338,049	540,000
Mjete transporti	72,708,450	-	-	72,708,450	0
Inventar Ekonomik	160,223,357	4,111,100	-	164,334,457	4,111,100
<b>Totali</b>	<b>602,053,583</b>	<b>11,573,125</b>	<b>-</b>	<b>613,626,708</b>	<b>11,573,125</b>

nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtim e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej 99% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “Inventarit ekonomik” e cila zë një peshë prej 46% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, llogaria “Mjete transporti” zë peshën prej 18% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2014. Llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” është shtuar nga viti shkuar dhe zë një peshë prej 5% të totalit të Aktiveve të Qëndrueshme.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2015, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2014), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivit	2015	2014	Diferenca 2015 - 2014
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QENDRUESHME</b>	<b>359,799,106</b>	<b>368,581,425</b>	<b>(8,782,319)</b>
<b>21,23,24,28</b>	<b>II. Aktive Të Qendrueshme Të Trupëzuara</b>	<b>359,799,106</b>	<b>368,581,425</b>	<b>(8,782,319)</b>
212	Ndërtim e Konstruksione	355,245,752	348,323,727	6,922,025
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	21,338,049	20,798,049	540,000
215	Mjete transporti	72,708,450	72,708,450	72,708,450
218	Inventar Ekonomik	164,334,457	160,223,357	4,111,100
219	Amortizim AQT	(253,827,602)	(233,472,158)	<b>(20,355,440)</b>
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>36,177,265</b>	<b>29,232,724</b>	<b>6,944,541</b>
Klasa 3	Gjendja e Inventarit	13,679,205	15,280,203	(1,600,998)
31	Materiale	10,032,697	12,045,475	(2,012,778)
32	Objekte inventari	3,646,508	3,234,728	411,780
<b>Klasa 4</b>	<b>II. Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>22,132,981</b>	<b>13,847,061</b>	<b>8,285,920</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin	22,132,981	13,847,061	<b>8,285,920</b>



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

50.59	III.Llogaritë financiare	365,079	105,460	259,619
520	Disponibilitete në thesar	365,079	105,460	259,619
	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>395,976,371</b>	<b>397,814,149</b>	<b>(32,683,794)</b>

Aktive Të Qëndrueshme paraqitet për 395,976,371 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara” plus Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që kap shumën 395,976,371 lekë, e cila ka dalë si diferencë midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 253,827,602 lekë.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë e grupit 212,214,215,218,219:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” gjatë vitit ka pësuar shtim në vlerën 6,922,025 lekë për punimet e rikonstruksionit të Sallës Vip të Institucionit. Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 21,338,049 lekë, është shtuar me 540,000 lekë për blerjet e pajisjeve të kondicionimit të Sallës Vip. Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 72,708,450 lekë është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2014. Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 164,334,457 lekë dhe është rritur me 4,111,100 lekë nga të cilat 840,000 lekë janë shtesa pa pagesë nga jashtë sistemit dhe 3,271,100 lekë janë blerje me pagesë të inventarit ekonomik si tavolina, kolltuqe, ndriçues etj. Si dhe amortizimi i aktive të qëndrueshme me vlerën 253,827,602 lekë.

Aktive Qarkulluese paraqiten më vlerën 36,177,265 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë:

Gjendja e inventarit paraqitet në shumën 13,679,205 lekë, duke pësuar një pakësim prej vitit të kaluar 2014 me 1,600,998 lekë. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” Në Pasqyrën përkatëse 3/1 llogaritë debitore. Paksimi në total vjen si rrjedhojë e daljes së materialeve të konsumit më tepër sesa shtesa e tyre, gjatë vitit.

Në përbërje të kësaj llogarie janë llogaria 31 “materiale” e cila në fund të vitit pasqyrohet me vlerën 10,032,697 lekë, me një pakësim prej 2,012,778 lekë nga viti shkuar, i cili përfaqëson përdorimin e materialeve të konsumit gjatë vitit si dhe llogaria 32 “objekte inventari” me vlerën prej 3,646,508 lekë e cila përfaqëson blerje artikuj inventari dhe është shtuar nga viti kaluar me 411,780 lekë, si blerje të flamujve kombëtar të qëndisur, blerje të pemës së vitit të ri, vazo qeramike me lule etj.

Kërkesa arkëtimi mbi debitorët paraqitet në shumën 22,132,981 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 4342 “të tjera operacione me shtetin” përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2015, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detyrimet ndaj furnitorëve për blerjet e bëra dhe kreditorëve për shërbimet e kryera, të cilat për këtë vit janë shtuar me 8,285,920 lekë, si më poshtë vijon: Paksimi prej 210.759 lekë në zërin e personelit vjen si rrjedhojë e pakësimit të numrit të punonjësve nga 76 (në fund të vitit 2014) në 75 (në fund të vitit 2015); e lidhur me të janë pakësimet për detyrimet për tatim taksa, prej 19,043 lekë dhe 48,617 lekë për sigurime shoqërore e shëndetësore. U shtuan detyrimet ndaj furnitorëve për 284,330 lekë për mallra të blera dhe të palikujduara në muajin dhjetor dhe shtesa prej 8,182,775 lekë ndaj kreditorëve për shërbime të kryera në këtë muaj e të palikujduara si



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

blerje dekoratash, kuti dhe dosje për to, marrje me qera të pajisjeve audio vizive, karrige, automjete, shërbimi LED, grup muzikor etj.

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 365,079 lekë dhe përfaqësohen me llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë 365,079 lekë, vlerë e cila është shtuar prej vitit 2014 me 259,619 lekë dhe përfaqëson mjete në ruajtje që i përket 5% të vlerës së sigurimit të kontratës, për garanci punimesh në rikonstruksionin e Sallës VIP të Institucionit (kontrata nr. 61/16, datë 3.07.2015, neni 44.4), si edhe vlera prej 105,460 lekë dhe përfaqëson fondin e pa përdorur nga viti 2014, nga sponsorizime të dhëna me destinacion sipas kontratave të lidhura, por që nuk mund të përdoret në destinacion tjetër (nuk e lejon kontrata).

Veprimet në lidhje me këtë llogari janë kryer në përputhje me Udhëzimin 14 datë 28.12.2006 ku specifikohet se llogaria 520 nuk mbyllet për gjendjen e mjeteve në ruajtje (evidentuar si të tilla në llogarinë 466), për sponsorizimet e të tjera të trashëgueshme. Teprica në këtë llogari, vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2015, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2014), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2015	2014	Diferenca 2015-2014
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>373,478,311</b>	<b>383,861,628</b>	<b>(10,383,317)</b>
101	Fonde bazë	373,478,311	383,861,628	(10,383,317)
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>22,392,600</b>	<b>13,847,061</b>	<b>8,545,539</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>Detyrime afatshkurtër</b>	<b>22,392,600</b>	<b>13,847,061</b>	<b>8,545,539</b>
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	1,773,280	1,488,950	284,330
42	Personeli e llogari të lidhura me to	5,300,691	5,511,450	(210,759)
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	632,240	651,283	(19,043)
435	Sigurime shoqërore	1,616,580	1,565,452	51,128
436	Sigurime shëndetsore	232,133	234,644	(2,511)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	259,619	0	259,619
467	Kreditorë të ndryshëm	12,578,057	4,395,282	8,182,775
85	Rezultati i ushtrimit	105,460	105,460	0
<b>X</b>	<b>TOTALI I PASIVIT (A+B)</b>	<b>395,976,371</b>	<b>397,814,149</b>	<b>1,837,778</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 1,837,778lekë, ose 0.46% më shumë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101“Fonde bazë”, është pakësuar këtë vit me vlerën 10,383,317lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitet të bilancit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, shtuar në vlerë nga 13,847,061 lekë një vit më parë, në 22,392,600 lekë pra janë shtuar këtë vit me shumën prej 8,545,539 lekë, si më poshtë:

Llogaria 401-408” Furnitore e llogari të lidhura me to” është shtuar këtë vit me 284,330 lekë si rrjedhojë e blerjeve të kryera dhe të palikujduara të muajt dhjetor duke arrit në vlerën 1,773,280 lekë.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit me vlerën 210,759 lekë si rrjedhojë e pakësimit të numrit të punonjësve nga 76 në 75.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor 2015, edhe është pakësuar këtë vit me vlerën -19,043 lekë si rrjedhojë e të pakësimit të 1 punonjësi.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit me vlerën 51,128 lekë, duke arritur vlerën prej 1,616,580 lekë. Megjithëse ka qenë 1 punonjës më pak, në shtesë ka ndikuar rritja e kufirit maksimal i pagës, për të cilën llogaritet përqindja e sigurimit shoqëror, si edhe rritja e përqindjes për sigurimin suplementar.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, është pakësuar këtë vit si rrjedhojë e pakësimit të 1 punonjësi me vlerën -2,511 lekë, duke arritur vlerën prej 232,133 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është krijuar këtë vit për vlerën 259,619 lekë dhe përfaqëson mjete në ruajtje që i përket 5% të vlerës së sigurimit të kontratës, për garanci punimesh në rikonstrukcionin e Sallës VIP të Institucionit.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është shtuar për 8,182,775 lekë si rrjedhojë e detyrimeve ndaj kreditorëve për shërbimet e kryera e të palikujduara të muajit dhjetor, pasi për këtë vit u shtuan më shumë aktivitetet në Institucion.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” mbartur në vlerën 105,460 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit si rezultat i një sponsorizimi që ka kryer Banka Societe General Albania për “Ballon Shqiptare” në 21.12.2013

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogaritë vjetore të vitit 2015, janë plotësuar si më poshtë:

Formati 3/1 “Shpenzimet e ushtrimit”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2015. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2015 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2014.

Analizuar si më poshtë vijonë:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën 193,133,440 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzime personeli” për 82,596,936 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Llogaria 601 “kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 11,603,607 lekë, llogaria 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për 96,212,639 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 2,134,680 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2014.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 5,641,900 lekë paraqet shumën e shpenzimeve specifike të Institucionit. Në këtë post janë vendosur gjithë shpenzimet që janë kryer për blerje të titujve, dekoratave dhe dhuratave.
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën 12,791,990 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje me roje civile.
- 6023 Shërbime transporti për shumën 9,940,880 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si naftë, vaj , pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 21,287,980 lekë përfaqësojnë shpenzimet që kryen institucioni për pagesën e udhëtimit, akomodimit dhe të dietave të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 3,763,068 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre dhe kryesisht mirëmbajtja e



faqes së internetit, e rrjetit kompjuterik, riparimet e automjeteve të Perdidentit dhe të administratës.

- 6026 shpenzime për qeramarrje përfaqëson marrjen me qera të automjeteve për pritje të personaliteteve të huaja dhe marrjen me qera të pajisjeve audio-vizive që përdoren në aktivitete të Presidentit në zona të ndryshme të vendit.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 31,978,591 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipër përmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor.

Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme" për shumën 942,413 lekë përfaqëson llogarinë 6040 "transferime tek nivele të tjera të Qeverisë" dhe përfshihen transfertat për shpërbime të menjëhershme me fonde nga Ministria e Financës, për Këshilltarë apo Ndhimësa të Presidentit, në momentin e largimit nga puna.

Llogaria 606 "Transferta tek buxhetet familjare" për shumën 176,847 lekë, përfaqëson dy shuma; konkretisht vlera prej 17,847 lekë, i përket pagesës për leje të zakonshme të një ish-punonjëse të larguar në vitin 2013, por që nuk kishte bërë lejen e zakonshme. (me transfertën e miratuar nga Ministria e Financave me nr. 13289/1 prot, datë 22.09.2015). Si dhe shuma prej 159,000 lekë e cila i përket vlerës së tatimit të shpërblimit për këshilltarë të larguar nga detyra, (me transfertën e miratuar nga Ministria e Financave me nr. 13441/4, datë 03.11.2015).

Gjithashtu pjesë e pasqyrës 3/1 "shpenzime të ushtrimit" janë edhe llogaritë:

llogaria 8421 "derdhje në buxhet e të ardhurave të papërdorura" janë kryesisht të ardhurat nga dhënia me qera e ambjentit të Institucionit për Bar-Kafe (139,800 lekë), ndërsa 1,000 lekë janë derdhje gabim në llogarinë e Institucionit nga subjekte private. Të gjitha derdhen në buxhet.

Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat e stokuara në magazinë, paraqitet me vlerën 1,600,998 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 85 "Rezultate nga funksionimi" prej përfaqëson diferencën pozitive midis totalit të operacioneve të të me totalin e operacioneve të shpenzimeve, në përputje me Udhëzimin 14 datë 28.12.006 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 "Saldo kreditore" e pasivit të pasqyrave financiare.

Formati 3/2 "Të ardhurat e ushtrimit", është plotësuar duke përfshirë të ardhurat jo tatimore, grantet korrente të brendshme nga i njëjti nivel qeverisje dhe financimin nga buxheti i shtetit. Pra kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2015. Të ardhurat ushtimore për 2015, janë në zërin e të ardhurave jo tatimore konkretisht llogaria 7109 "Të ardhura jotatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia" për 139,800 lekë, shtuar nga viti shkuar me 23,300 lekë. E cila përfaqëson vlerën e qerasë së 2 muajve (11,650x2) si dhe një shumë prej 1,000 lekë e cila është derdhur gabim në llogarinë e institucionit.

Si dhe llogaria 720 "Grant korrent i brendshëm" të përbërë nga llogaria 7200 grant korrent i brendshëm nga i njëjti nivel qeverisje për vlerën 169,399,461 lekë, shtuar nga viti kaluar me 12,818,215 lekë si rrjedhojë e shtesës së fondeve dhe përfaqëson shtesën e shpenzimeve, si rrjedhim i shtimit të veprimtarisë dhe aktiviteteve në Institucion Llogaria 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" me vlerën 22,132,981 lekë, përfaqëson vlerën e detyrimeve të papaguara të vitit 2015, që do të paguhet në vitin 2016 dhe është shtuar nga viti i shtuar me 8,285,920 lekë si rrjedhojë e shtesës së shpenzimeve operative. Llogaria 7206 "Sponsorizime nga të tretë" në vlerën 105,460 lekë, përfaqëson një sponsorizim që ka kryer Banka Societe General Albania për "Ballon Shqiptare" në 21.12.2013 në operacionet korrigjuese të rezultatit kemi derdhje të ardhurash me vlerë 1,600,998 lekë. Nga auditimi konstatohet se kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është





## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2014.

Formati nr.4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” përfaqëson burimet për investime të kryera gjatë vitit 2015 dhe është realizuar nga granti i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje për 10,733,125 lekë dhe nga grantë të brendshme në natyrë me vlerë 840,000 lekë. Sa më sipër përfaqësojnë shpenzimet për Rikonstruksionin e Sallës Vip, me fonde nga buxheti i shtetit dhe vlera e një piktore të dhuruar për Institucionin.

Gjithashtu brenda kësaj pasqyre gjendet llogaria shpenzime për rritjen AQ të trupëzuara me vlerë 6,922,025 lekë ndërtime dhe konstruksione, 540,000 leke makineri e pajisje dhe 3,271,100 lekë inventarë ekonomik.

Formati nr.5 “Pasqyra e levizjes “Cash” për vitin 2015”, është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të regjistruar fondet buxhetore korrente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korrente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadruara nga dega e thesarit. Nga auditimi konstatohet se, “Teprica në mbyllje” rakordon me shumën që figuron në postin përkates të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.

Formati nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) 2015”, është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Në zërin shtesa janë përfshirë katër shuma, njëra pa pagesë jashtë sistemit për 840,000 lekë dhe tre të tjerat për blerje të realizuara gjatë vitit për 10,733,125 lekë. Nga auditimi konstatohet se, gjendjet në çelje dhe në mbyllje të ushtrimit për çdo kategori të aktiveve të qëndrueshme janë të barabarta me të dhënat e evidentuara për to në postet e aktiveve të qëndrueshme në aktiv të bilancit kontabël.

Për vitin 2015, Institucioni i Presidentit, bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe në Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave ka kryer inventarizimin e pasurisë së institucionit. Për këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë Urdhërin nr. 2208 prot, datë 21.12.2015 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve. Në mbështetje të tij u ngrit komision për inventarizimin dhe vlerësimin e vlerave materiale të zyrave dhe komision për inventarizimin e materialeve në magazinë dhe të automjeteve. Nga relacioni i inventarizimit, rezulton se për vitin 2015 janë të pranishme materiale shumë të konsumuara apo dëmtuara të cilat janë mallra për nxjerrje jashtë përdorimit pasi kosto e mbajtjes së tyre rezulton më e lartë nga përfitimi prej përdorimit të tyre. Por nga auditimi u konstatua se për vitin 2015 praktika e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk ka funksionuar.

Nga krahasimi i gjendjes fizike me atë kontabël nuk janë evidentuar diferenca dhe se, të gjitha fletët e inventarit janë plotësuar në sasi dhe në vlerë dhe janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe nga personat materialisht përgjegjës. Fletët e inventarit dhe kartelat personale të çdo punonjësi ishin të rakorduar me përmbledhësen e inventarit.

Formati nr.7 “Pasqyra e amortizimit vjetor”, pasqyra është plotësuar konform kërkesave të VKM nr.401 të vitit 1989 dhe shumat e kësaj pasqyre kanë korrespondencë me shumat e sistemuara në aktiv të bilancit.

Formati 8 Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në çelje dhe përfundim të ushtrimit të vitit 2015 ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime, rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim është kryer konform kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël. Gjendja në fund e saj është e barabartë me pasivin e bilancit, e kuadruar me fondin në total.

Formati nr.9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen lëvizjet dhe gjendja në fund e punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

plotësuar sipas të dhënave nga pasyra e shpenzimeve. Numri i punonjësve për 2016 korrespondon me strukturën faktike.

#### Për vitin 2016

Edhe për këtë vit ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Sektorit të Financës, të përbërë nga Sektori i Financës dhe Buxhetit.

Mbas verifikimeve shifrat e rakorduara në të dy pozicionet, pra degë thesari & bankë, janë regjistruar dhe rakorduar në rregull.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2016 mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Institucionin e Presidentit, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë.

b. Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, është përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 341 prot, datë 16.02.2017, e konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2016 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formateve nr.1&2; Pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave (Formatet nr.3/1 & 3/2); Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr.4); Pasqyrën mbi lëvizjen “CASH” (Formati nr.5); Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme si dhe Amortizimin e tyre (Formati nr.6 &7); Pasqyrën e lëvizjes së fondeve (Formati nr.8); Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Pasqyra nr.9) dhe Relacionin shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2016, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2016-2015), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

Grupimi i llogarive te aktivit	Ushtrimi për vitin		Pesha		Diferenca
	2016	2015	2016	2015	
Aktive të Qëndrueshme	343,365,858	359,799,106	88%	91%	-16,433,248
Aktive Qarkulluese	45,075,933	36,177,265	12%	9%	8,898,668
Llogari të tjera	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktivit</b>	<b>388,441,791</b>	<b>395,976,371</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>-7,534,580</b>

Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2015 Aktivet e Qëndrueshme kanë zënë 91% të totalit të Aktivit (ose rreth 360 mijë lekë) dhe Aktivet Qarkulluese zinin 9% të totalit (ose rreth 36 mijë lekë). Gjatë vitit 2015 ky raport ka ndryshuar me trend rënës për Aktivet e Qëndrueshme, të cilat kanë zënë 88% të totalit të Aktivit (ose rreth 343 mijë lekë); me një rënie prej 16,433,248 lekë krahasuar me një vit më parë. Dhe Aktivet Qarkulluese zënë 12% të totalit të aktiveve (ose rreth 45 mijë lekë), konkretisht me një rritje prej 8,898,668 lekë krahasuar me 2015.

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

*Në lekë*

Aktive	Celja në fund të vitit 2015	Shtesa gjatë vitit 2016	Pakësime gjatë vitit 2016	Gjendja në mbyllje, viti 2016	Ndryshimi



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

<i>Aktive të trupëzuara</i>					
Ndërtim edhe konstruksione	355,245,752	214,272	-	355,460,024	214,272
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	21,338,049	-	-	21,338,049	0
Mjete transporti	72,708,450	-	-	72,708,450	0
Inventar Ekonomik	164,334,457	4,286,991	-	168,621,448	4,286,991
<b>Totali</b>	<b>613,626,708</b>	<b>4,501,263</b>	<b>-</b>	<b>618,127,971</b>	<b>4,501,263</b>

nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej 58% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “Inventarit ekonomik” e cilazë një peshë prej 27% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, llogaria “Mjete transporti” zë peshën prej 12% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2015. Po ashtu edhe llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” është mbart e pandryshuar nga viti shkuar dhe zë një peshë prej 3% të totalit të Aktiveve të Qëndrueshme.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2016, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2014), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2016	2015	Diferenca 2016 - 2015
<b>A</b>	<b>AKTIVE TË QENDRUESHME</b>	<b>343,365,858</b>	<b>359,799,106</b>	<b>(16,433,248)</b>
<b>21,23,24,28</b>	<b>II. Aktive Të Qendrueshme Të Trupëzuara</b>	<b>343,365,858</b>	<b>359,799,106</b>	<b>(16,433,248)</b>
212	Ndërtime e Konstruksione	355,460,024	355,245,752	214,272
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	21,338,049	21,338,049	0
215	Mjete transporti	72,708,450	72,708,450	0
218	Inventar Ekonomik	168,621,448	164,334,457	4,286,991
219	Amortizim AQT	(247,762,113)	(253,827,602)	(6,065,489)
<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>45,075,933</b>	<b>36,177,265</b>	<b>8,898,668</b>
Klasa 3	Gjendja e Inventarit	13,407,897	13,679,205	(271,308)
31	Materiale	9,531,250	10,032,697	(501,447)
32	Objekte inventari	3,876,647	3,646,508	230,139
<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët</b>	<b>31,302,957</b>	<b>22,132,981</b>	<b>9,169,976</b>
4342	Të tjera operacione me shtetin	31,302,957	22,132,981	9,169,976
<b>50.59</b>	<b>III.Llogaritë financiare</b>	<b>365,079</b>	<b>365,079</b>	<b>0</b>
520	Disponibilitete në thesar	365,079	365,079	0
	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>388,441,791</b>	<b>395,976,371</b>	<b>(7,534,580)</b>

Aktive Të Qëndrueshme paraqitet për 343,365,858 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara” plus Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që kap shumën 343,365,858 lekë, e cila ka dalë si diferencë midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 274,762,113 lekë.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë e grupit 212,214,215,218,219:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” gjatë vitit ka pësuar shtim në vlerën 214,272 lekë për shkak të blerjes me pagesë të Projektpreventivit, çka përfshin kontraktimin për hartimin e projektpreventivit për projektin “Rikonstruksion dhe mobilim i Zyrës së Presidentit” Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 21,338,049 lekë, mbartur i pa ndryshuar nga viti shkuar dhe kjo llogari përfaqëson aktive të trupëzuara, afatgjatë, si pajisje dhe instalimi i kondicionerëve, pajisje audio-vizuale, korëse bari etj., të cilat për vitin 2016 nuk kanë ndryshime. Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 72,708,450 lekë dhe po ashtu është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2015. Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 164,334,457 lekë dhe është rritur me 4,286,991 lekë, nga të cilat 285,400 lekë janë shtesa pa pagesë nga jashtë sistemit dhurata të ardhura në vite, ndërsa vlera prej 4,001,591 lekë janë blerje me pagesë të Pajisjeve kompjuterike, me fletë hyrjen nr. 120, datë 6.06.2016, nr.108, datë 13.05.2016 dhe nr. 63, datë 1.04.2016, si edhe amortizimi i aktive të qëndrueshme me vlerën 274,762,113 lekë.

Aktive Qarkulluese paraqiten më vlerën 45,075,933 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë:

Gjendja e inventarit paraqitet në shumën 13,407,897 lekë, duke pësuar një pakësim prej vitit të kaluar 2015 me 271,308 lekë. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve”, në Pasqyrën përkatëse 3/1 llogaritë debitore. Paksimi në total vjen si rrjedhojë e daljes së materialeve të konsumit më tepër sesa shtesa e tyre, gjatë vitit.

Në përbërje të kësaj llogarie janë llogaria 31 “materiale” e cila në fund të vitit pasqyrohet me vlerën 9,531,250 lekë, me një pakësim prej 501,447 lekë nga viti shkuar, i cili përfaqëson përdorimin e materialeve të konsumit gjatë vitit, si dhe llogaria 32 “objekte inventari” me vlerën prej 3,876,647 lekë e cila përfaqëson blerje të inventarit të imët dhe është shtuar nga viti i kaluar me shumën 230,139 lekë, shtim i ardhur prej blerjes së një objekti për aparatin fotografik dhe të një valixheje për dhuratat.

Kërkesa arkëtimi mbi debitorët paraqitet në shumën 31,302,957 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 4342 “të tjera operacione me shtetin” përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2016, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detyrimet ndaj furnitorëve për blerjet e bëra dhe kreditorëve për shërbimet e kryera, të cilat për këtë vit janë shtuar me 9,169,976 lekë, si më poshtë vijon: Shtesa prej 106,607 lekë në zërin e personelit vjen si rrjedhojë e shtimit të numrit të punonjësve nga 75 (në fund të vitit 2015) në 76 (në fund të vitit 2016) duke arrit numrin e vendosur dhe me buxhet; e lidhur me të janë shtesat për detyrimet për tatim taksa, prej 17,931 lekë dhe shtesa prej 32,896 lekë dhe 5,127 lekë për sigurime shoqërore e shëndetësore. U shtuan detyrimet ndaj furnitorëve prej 7,319,239 lekë për mallra të blera dhe të palikujduara në muajin dhjetor dhe shtesa prej 1,688,176 lekë ndaj kreditorëve për shërbime të kryera në këtë muaj e të palikujduara.

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 365,079 lekë dhe përfaqëson llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë 365,079 lekë vlerë e cila mbartet e pandryshuar prej vitit 2015.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2016, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2016-2015), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2016	2015	Diferenca 2016-2015
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>356,773,755</b>	<b>373,478,311</b>	<b>-16,704,556</b>
101	Fonde bazë	356,773,755	373,478,311	-16,704,556
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>31,562,576</b>	<b>22,392,600</b>	<b>9,169,976</b>
<b>Klasa 4</b>	<b>Detyrime afatshkurtër</b>	<b>31,562,576</b>	<b>22,392,600</b>	<b>9,169,976</b>
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	9,092,519	1,773,280	7,319,239
42	Personeli e llogari të lidhura me to	5,407,298	5,300,691	106,607
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	650,171	632,240	17,931
435	Sigurime shoqërore	1,649,476	1,616,580	32,896
436	Sigurime shëndetsore	237,260	232,133	5,127
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	259,619	259,619	0
467	Kreditorë të ndryshëm	14,266,233	12,578,057	1,688,176
85	Rezultati i ushtrimit	105,460	105,460	0
<b>X</b>	<b>TOTALI I PASIVIT (A+B)</b>	<b>388,441,791</b>	<b>395,976,371</b>	<b>-7,534,580</b>

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 7,534,508 lekë, ose % më pak, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101“Fonde bazë”, është pakësuar këtë vit me vlerën 16,704,556 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, shtuar në vlerë nga 22,392,600 lekë një vit më parë, në 31,562,576 mijë lekë pra janë shtuar këtë vit me shumën prej 9,169,976 lekë, si më poshtë:

Llogaria 401-408” Furnitore e llogari të lidhura me to” është shtuar këtë vit me 7,319,239 lekë si rrjedhojë e blerjes së mallarave në muajin dhjetor duke arrit në vlerën 9,092,519 lekë. Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është shtuar këtë vit me vlerën 106,607 lekë si rrjedhojë e ndryshimit të numrit të punonjësve nga 75 në 76 në fund të vitit 2016. Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson derdhjen e tatimit nga të ardhurat dhe është shtuar këtë vit me vlerën 17,931 lekë si rrjedhojë e shtesës së 1 punonjësi. Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit me vlerën 32,896 lekë, duke arritur vlerën prej 1,649,476 lekë si rrjedhojë e shtesës së 1 punonjësi. Llogaria 436 “Sigurime shëndetsore”, është shtuar këtë vit si rrjedhojë e shtesës së 1 punonjësi me vlerën 5,127 lekë, duke arritur vlerën prej 237,260 lekë. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është mbartur e pandryshuar për 259,619 lekë dhe përfaqëson mjete në ruajtje që i përket 5% të vlerës së sigurimit të kontratës, për garanci punimesh në rikonstruksionin e Sallës VIP të Institucionit. Llogaria 467“Kreditorë të ndryshëm”, është shtuar për 1,688,176 lekë si rrjedhojë e shtesës së shërbimeve dhe përfaqëson detyrimet për shërbimet e kryera nga subjektet në muajin dhjetor e të palikujduara, si shërbime për ceremoni pritjesh me koktejlle e darka, shërbime me karrike me qera, bileta udhëtimesh, rregullimi i dekorit të qytetit për raste vizitash të personaliteteve të huaja. Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” mbartur në vlerën 105,460 lekë dhe përfaqëson fondin e pa përdorur nga viti 2014, nga sponsorizimet.

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogaritë vjetore të vitit 2016, janë plotësuar si më poshtë:

Formati 3/1“Shpenzimet e ushtrimit”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetsore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2016. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë më 31 Dhjetor 2016 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2015.

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën 206,101,513 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzimeve personeli” për 83,405,338 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Llogaria 601 “kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 11,750,330 lekë, llogaria 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për 110,474,537 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 2,526,882 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2016.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 9,561,930 lekë paraqet shumën e shpenzimeve specifike të Institucionit. Në këtë post janë vendosur gjithë shpenzimet që janë kryer për blerje të titujve, dekoratave dhe dhuratave.
- 6022 Shërbime nga të tretë për shumën 12,967,760 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje me roje civile.
- 6023 Shërbime transporti për shumën 8,947,790 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si naftë, vaj , pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 43,458,310 lekë përfaqësojnë shpenzimet që kryen institucioni për pagesën e udhëtimit, akomodimit dhe të dietave të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 3,693,452 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre dhe kryesisht mirëmbajtja e faqes së internetit, e rrjetit kompjuterik, riparimet e automjeteve të Perdidentit dhe të administratës.
- 6026 shpenzime për qeramarrje për shumën 5,299,380 lekë përfaqëson marrjen me qera të automjeteve për pritje të personaliteteve të huaja dhe marrjen me qera të pajisjeve audio-vizive që përdoren në aktivitete të Presidentit në zona të ndryshme të vendit.
- 6027 shpenzime për qeramarrje për shumën 576,340 lekë përfaqëson detyrime legale të institucionit.
- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 23,442,693 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor.

Llogaria 606 “Transferta tek buxhetet familjare” për shumën 200,000 lekë, përfaqëson përdorimin e fondit të veçantë për dy ndihma ekonomike dhe një dalje në pension.

Gjithashtu pjesë e pasqyrës 3/1 “shpenzime të ushtrimit” janë edhe llogaritë:

Llogaria 8421 “derdhje në buxhet e të ardhurave të papërdorura” për shumën 190,000 lekë dhe janë të ardhurat nga dhënia me qera e ambjentit të Institucionit për Bar-Kafe.

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat e stokuara në magazinë, paraqitet me vlerën 271,308 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 85 “Rezultate nga funksionimi” përfaqëson diferencën pozitive midis totalit të operacioneve të të ardhurave me totalin e operacioneve të shpenzimeve, në përputje me Udhëzimin 14 datë 28.12.006 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 “Saldo kreditore” e pasivit të pasqyrave financiare.





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Formati 3/2 “Të ardhurat e ushtrimit”, është plotësuar duke përfshirë të ardhurat jo tatimore, grantet korente të brendshme nga i njëjti nivel qeverisje dhe financimin nga buxheti i shtetit. Pra kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2016. Të ardhurat ushtimore për 2016, janë në zërin e të ardhurave jo tatimore konkretisht llogaria 7109 “Të ardhura jotatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” për 190,000 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 50,200 lekë, e cila përfaqëson ndryshimin e çmimit të qerasë për një ambient në Institucion, dhënë për funksion Bar- Kafe.

Si dhe llogaria 720 “Grant korrent i brendshëm ” të përbërë nga llogaria 7200 “Grant korrent i brendshëm nga i njëjti nivel qeverisje” për vlerën 174,527,248 lekë, shtuar nga viti kaluar me 5,127,787 lekë si rrjedhojë e shtimit të fondeve dhe përfaqëson shtesën e shpenzimeve për këtë kategori shpenzimesh si rrjedhim i shtimit të veprimtarisë dhe aktiviteteve në Institucion. Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti“ me vlerën 31,302,957 lekë, përfaqëson detyrimet e mbartura nga viti 2016 që do të likujdohen në vitin 2017 dhe është shtuar nga viti i shkuar me 9,169,976 lekë si rrjedhojë e shtesës së shpenzimeve si rrjedhojë e shtimit të veprimtarisë dhe aktiviteteve në Institucion. (Për shkak të natyrës së veçantë të vet Institucionit egzistojnë aktivitete të paparashikuara) Llogaria 7206 “Sponsorizime nga të tretë“ mbartur në vlerën 105,460 lekë, përfaqëson fond të papërdorur nga sponsorizimet, nga viti 2014, në operacionet korrigjuese të rezultatit kemi vlerën prej 271,308 lekë, të cilat vijnë nga ndryshimi i gjendjes së inventarit dhe janë pakësuar nga viti 2015 me 1,329,690 lekë si rrjedhojë e pakësimit të inventarit.

Për grantet e brendshme e të huaja kapitale që institucioni përfiton në natyrë veprimi kontabël të bëhet direkt. Fillimisht debi llogaritë e grupit 23 të AQ në kredi të llogarive respektive 1059 ”Grante të brendshme kapitale në natyrë” dhe 1069 ”Grante të huaja kapitale në natyrë” dhe paralel debi llogaritë përkatëse të grupit 21 të AQ në kredi të llogarive përkatëse të grupit 23 “shpenzime për krijimin e AQ”. Nga auditimi konstatohet se kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2016.

Formati nr.4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” përfaqëson shpenzimet për investime të kryera gjatë vitit 2016 dhe është realizuar nga granti i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje për 10,733,125 lekë dhe nga grante të brendshme në natyrë me vlerë 840,000 lekë. Sa më sipër përfaqësojnë investimet e kryera me fonde buxhetore dhe pjesa tjetër investime nga dhurimet në vite, të cilat nuk kanë qenë të vlerësura. Gjithashtu brenda kësaj pasqyre gjendet llogaria 231 ”Shpenzime për rritjen AQ të trupëzuara me vlerë 4,286,991 lekë që përfaqëson inventarin ekonomik.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2016 në formatin 4 “burime dhe shpenzime lidhur me investimet”, llogaria “shpenzime për investime” pasqyrohet e barabartë me llogarinë “grante të brendshme kapitale” që përfshinë llogarinë “grant i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje” dhe “grant i brendshëm në natyrë” ndërkohë që në vitin 2015 llogaria “shpenzime për investime” pasqyrohet e barabartë me llogarinë “grant i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje” pa përfshirë atë në natyrë.

Formati 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” klasa II. Llogaria “shpenzime për investime” duhet të rakordojë me formatin 6 “gjendje dhe ndryshim i aktiveve të qendrueshme të trupëzuara” nisur nga veprimet e mësipërme ndodh të cedohet në shifra për njërin vit.

Formati nr.5 “Pasqyra e levizjes “Cash” për vitin 2016”, është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të regjistruar fondet buxhetore korrente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korrente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadratura nga dega e thesarit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Nga auditimi konstatohet se, “Teprica ne mbyllje” rakordon me shumëen që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.

Formati nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) 2016”, është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Në zërin shtesa janë përfshirë tre shuma, njëra pa pagesë jashtë sistemit për 285,400 lekë dhe dy të tjerat për blerje të realizuara gjatë vitit për 4,215,863 lekë. Nga auditimi konstatohet se, gjendjet në çelje dhe në mbyllje të ushtrimit për çdo kategori të aktiveve të qendrueshme janë të barabarta me të dhënat e evidentuara për to në postet e aktiveve të qendrueshme në aktiv të bilancit kontabël.

Për vitin 2016, Institucioni i Presidentit, bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe në Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave ka kryer inventarizimin e pasurisë së institucionit. Për këtë qëllim, Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhërin nr. 2380 prot, dt. 16.12.2016 për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve. Mbështetur në të u ngritën komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e vlerave materiale të zyrave si dhe ai për inventarizimin e materialeve në magazinë dhe të automjeteve.

Nga relacioni i inventarizimit, rezulton se edhe për vitin 2016 janë të pranishme materiale shumë të konsumuara apo dëmtuara kosto e mbajtjes së të cilave rezulton më e lartë se përfitimi prej përdorimit të tyre dhe vlerësohen si mallra për nxjerrje jashtë përdorimit. Por nga auditimi u konstatua se, edhe për vitin 2016 praktika e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk ka funksionuar. Nga auditimi u konstatua se, gjatë të tre viteve periudhë auditimi, 2014, 2015 dhe 2016 ende nuk është përfunduar procedura për regjistrimin e pronësisë mbi godinën, bazuar në ligjin nr. 8743, dt. 22.02.2011, i ndryshuar “Për inventarizimin e pronës shtetërore”, Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga krahasimi i gjendjes fizike me atë kontabël nuk janë evidentuar diferenca dhe se, të gjitha fletët e inventarit janë plotësuar në sasi dhe në vlerë dhe janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe nga personat materialisht përgjegjës. Fletët e inventarit dhe kartelat personale të çdo punonjësi ishin të rakorduar me përmbledhësen e inventarit.

Formati nr.7 “Pasqyra e amortizimit vjetor”, pasqyra është plotësuar konform kërkesave të VKM nr.401 të vitit 1989 dhe shumat e kësaj pasqyre kanë korrespondencë me shumat e sistemuara në aktiv të bilancit.

Formati 8 Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në çelje dhe përfundim të ushtrimit të vitit 2016 ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime, rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim është kryer konform kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël. Gjendja në fund e saj është e barabartë me pasivin e bilancit, e kuadruar me fondin në total.

Formati nr.9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen lëvizjet dhe gjendja në fund e punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasyra e shpenzimeve. Numri i punonjësve për 2016 korrespondon me strukturën faktike.

Si përfundim nga auditimi i kryer mbi pasqyrat financiare të Institucionit të Presidentit të Republikës, lidhur me procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive, përmbajtjes dhe plotësimit të pasqyrave financiare, konstatohet se, përgjithësisht është operuar në përputhje Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28/12/2006 “për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit e zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

të huaj”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26 datë 27.12.2007 me përjashtim të disa anomalive jomateriale në hartimin e formatit 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” siç jemi shprehur më tepër në trajtimin e kësaj pasqyre financiare gjatë materialit

#### **IV. 4. Auditimi i zonave të llogarisë**

##### **4.1. Paga, shpërblime, të tjera personeli (llog. 600)si dhe sigurime shoqërore. (llog.601).**

###### **- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhënjet e punës dhe pagave.**

Në Institucionin e Presidentit të Republikës, organizimi dhe funksionimi mbështet në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Bazuar në këtë legjislacion, Administrata e Institucionit të Presidentit të Republikës gjate gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014 deri në 6 mujin e parë të vitit 2017, ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës, të miratuar me Vendime të Presidentit të Republikës “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”, si më poshtë:

- Për periudhën 01.07.2014 – 10.09.2014 me vendimin nr. 299, datë 7.01.2014;
- Për periudhën 11.09.2014 – 11.09.2014 me vendimin nr. 308, datë 11.09.2014;
- Për periudhën 11.09.2014 – 05.11.2014 me vendimin nr. 314, datë 05.11.2014;
- Për periudhën 06.11.2014 – 28.01.2015, me vendimin nr. 321, datë 28.01.2015;
- Për periudhën 29.01.2015 – 17.02.2015, me vendimin nr. 327, datë 17.02.2015;
- Për periudhën 18.02.2015 – 26.11.2015, me vendimin nr. 332, datë 26.11.2015;
- Për periudhën 18.02.2015 – 30.04.2017, me vendimin nr. 341, datë 09.12.2016

Në bazë të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe aktet normative që kanë ndryshuar këto ligje gjatë vitit, si dhe strukturave përkatëse të miratuara, numri gjithsej i punonjësve për Institucionin e Presidentit në periudhën objekt auditimi ka qenë mesatarisht 76 punonjës.

Pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në organikën e institucionit gjatë periudhës objekt auditimi, administrata e Institucionit të Presidentit të Republikës, ka vijuar punën duke mbajtur në fuqi Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Presidentit të Republikës”, të miratuar me Vendimin e Presidentit me nr. 230/1, datë 02.02.2011, duke mos reflektuar ndryshimet në strukturë.

Nga përmbajtja e rregullore së Brendshme të Institucionit, rezulton se janë evidentuar përgjegjësitë në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, detyrat kryesore materializohen në përshkrimin e punës që duhet të përmbushin pozicionet e nëpunësit në nivel Drejtorie. Në këtë rregullore nuk janë evidentuar detyrat specifike dhe përgjegjësitë që duhet të kryejë cdo pozicion pune, pjesë e shërbimit civil si Përgjegjës Sektori apo Specialist.

Nr	Drejtore sipas organikes (2016 & 2017)	Drejtore sipas Rregullores
1	Drejtorja e Planifikimit dhe Menaxhimit	Drejtorja Ekonomike dhe e Burimeve Njerezore
2	Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Komunu.	Drejtorja e Informimit publik dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3	-	Drejtorja e Shërbimeve mbështetëse
4	-	Njësia e Prokurimit
5	-	Drejtorja Juridike dhe e Koordinimit

###### **- Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin**

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për periudhën 01.07.2014 deri më 30.06.2017, Institucioni i presidentit është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrat përkatës të sipër cituar. Bazuar në këtë strukturë organizative institucioni ka mesatarisht **76 punonjës** të miratuar nga te cilët:

- Drejtor Drejtorie 2
- Përgjegjës Sektori 6
- Specialist 23
- Punonjës mbështetës 12
- Teknik 4
- Stafi politik 25+4 sekretar

Në strukturë 31 punonjës i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe 16 prej tyre me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ”Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

Numri i punonjësve në total në terma mesatar, sipas organikës krahasuar me faktin si dhe fondi i pagave për periudhën objekt auditimi, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.1 Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave /lek

Nr	VITI	Nr. Punonjsve		Fondi i pagave		% realizimit
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	
1	2014(6 m )	76	76	79,102,346	78,993,984	99.87
2	2015	76	75	82,982,153	82,770,451	99.75
3	2016	76	76	83,500,000	83,261,657	99.72
4	2017 (4 m)	76	76	29,000,000	28,639,359	98.76

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga sektori i financës dhe përpunuar nga audituesi

Nga sa më sipër rezulton se, në institucionin e Presidentit të Republikës për periudhën objekt auditimi, nuk e ka tejkaluar në asnjë rast numrin mesatar të punonjësve. Fondi i pagave për këtë periudhë është realizuar mesatarisht në masën 99.75%.

#### - Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj.

Fondi i veçantë, është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr. 826, datë 05.12.2011, duke u përdorur pjesërisht kryesisht për rastet e veçanta si, për dalje në pension dhe fatkeqësi. Rezulton se janë kryer pagesa për fatkeqësi në familje gjithsej në vlerën 60 mijë lekë dhe për dalje në pension në vlerën 140 mijë lekë, Fondi i veçantë, nuk është përdorur për shpërblimin e punonjësve në fund të çdo viti ushtrimor, të dhënat paraqiten në tabelën si më poshtë

Tabela nr.3

nr	EMERTIMI	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	82,982,153	82,770,451	99.7	83,500,000	83,261,657	99.7	29,000,000	28639359	98.7
2	Sig. Shoqërore (601)	11,700,000	11,611,277	99.2	11,800,000	11,731,450	99.4	4,400,000	3984977	90.6
3	Fondi i veçantë					200,000				

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se, sigurimet shoqërore për vitin 2015, 2016 janë realizuar në masën 99.4%, ndërsa për tremujorion e katërt të vitit 2017 në 90.6 %.

-Në Institucionin e Presidentit, është krijuar komisioni i përhershëm disiplinor, me urdhërin nr. 28, datë 07.11.2014, ku është përfshijë një përfaqësues të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Konstatohet se ky komision nuk është rinovuar pas largimit nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, në cilësinë e kryetarit të komisionit të disiplinës.



**- Mbi pagesat për gradë shkencore**

Në zbatim të VKM nr. 545, datë 11.8.2011 " Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civile" ndryshuar me VKM nr. 449, datë 11.07.2012 si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 16.03.2012, të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në Institucionin e Presidentit të Republikës për periudhën objekt auditimi janë paguar dy persona të cilët kanë gradë shkencore "Doktor i shkencave", që në strukturë kanë funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe ndihmës i Presidentit. Gjithsej shuma e përfituar është në vlerën 1,240 mijë lekë.

**- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.**

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës së institucionit dhe se janë respektuar nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve për punonjësit e institucionit, dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë. Nga auditimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të pagës bruto, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si Cv, diplome, listë notash, çertifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj., janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në zbatim të 152/2013 "Për nëpunësin civil" si dhe VKM nr.116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil". Regjistri i personelit elektronik, është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku janë regjistruar të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë dhe për punonjësit e emëruar me kontratë.

Libri i pagave, për periudhën objekt kontrolli, është plotësuar për të gjithë punonjësit që janë në marrëdhënie pune, ku janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.

**IV. 4.2 Mallra dhe shërbime (llog. 602).**

**- Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.**

Nga auditimi i kryer për veprimet e arkës dhe të bankës rezultoi se, veprimet kontabël janë kryer në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre", i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe të njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", ndryshuar me udhëzimet e MF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008.

**- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe në valutë.**

Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, ka tërhequr nga banka 19,229 lekë dhe janë kryer 11 pagesa nëpërmjet arkës në lekë në shumën 19,229 lekë për blerje të domosdoshme, ndërsa për vitin 2015 nga 62,500 lekë të tërhequra janë kryer 20 pagesa në shumën 62,500 lekë. Për vitin 2016 ka tërhequr nga 98,170 lekë të tërhequra janë kryer 28 pagesa në shumën 98,170 lekë. Për gjashtë





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

mujorin e parë të vitit 2017 ka tërhequr nga banka 34,729 lekë të tërhequra janë kryer 6 pagesa në shumën 34,729 lekë.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në valutë rezultoi se për periudhën objekt auditimirezulton:

- për vitin 2014 nga 60,000 Euro të parashikuara në plan janë shpenzuar 50,340 Euro dhe nga 50,000 USD të parashikuara janë shpenzuar 36,350 USD,
- për vitin 2015 nga 50,000 Euro të parashikuara në plan janë shpenzuar 45,100 Euro dhe nga 40,000 USD të parashikuara janë shpenzuar 17,500 USD,
- për vitin 2016 nga 50,000 Euro të parashikuara në plan janë shpenzuar 111,000 Euro dhe nga 40,000 USD të parashikuara janë shpenzuar 66,000 USD,
- për vitin 2017 nga 60,000 Euro të parashikuara në plan janë shpenzuar 18,300 Euro dhe nga 40,000 USD të parashikuara janë shpenzuar 7,700 USD, shpenzime të cilat janë kryer kryesisht shpenzime për shërbime udhëtimi e dieta jashtë shtetit.

Regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës. Është mbajtur dhe rakorduar libri i arkës në valutë sipas monedhave të tërhequra, në Usd dhe në Euro, për të gjithë periudhën objekt auditimi. Nga Sektori i Financës çdo muaj është bërë inventarizimi i valutës gjendje në arkë dhe nuk u konstatuan diferenca.

U bë rakordimi i tërheqjeve nga banka me arkëtimet e arkës në valutë dhe rezultoi se, të gjitha mjetet monetare të tërhequra nga banka janë bërë hyrje në arkë me mandatarkëtim. Për të gjitha shërbimet e kryera jashtë shtetit është dhënë paradhënie sipas urdhrave të titullarit dhe në përfundim të shërbimit, janë bërë përlllogaritjet e shpenzimeve sipas programeve të hartuara për çdo rast dhe është bërë mbyllja e paradhënies.

Nga auditimi i praktikave të shpenzimeve të kryera në valutë për udhëtim e dieta jashtë shtetit, rezultoi se, të gjithë mandatpagesave të lëshuar, u janë bashkëlidhur borderotë e paradhënieve të nënshkruar nga secili punonjës udhëtues, ku janë bërë edhe përlllogaritjet përkatëse për argumentimin e paradhënies së tërhequr, shoqëruar edhe me programet e masave për secilën vizitë që ka bërë Presidenti i Republikës jashtë shtetit. Në këto programe janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat e strukturave përkatëse që ngarkohen me organizimin e vizitave. Në të gjitha rastet janë përcaktuar detyrimet financiare që marrin përsipër palët pritëse dhe ato që do të përballohen nga vetë institucioni.

#### ***-Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve me bankën.***

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të bankës për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2014 deri më datë 30.06.2017 rezultoi se, veprimet kontabël në përgjithësi janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës është bërë në llogarinë 580 “Xhirimi i vlerave monetare”, llogari e cila në fund të periudhës paraqitet e mbyllur.

Të gjitha Urdhër Shpenzimet janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me ekstraktin e saj.

#### ***4.3. Shpenzimeve për investime (llog 230,dhe 231)***

Për periudhën objekt auditimi Institucioni i Presidentit të Republikës për plotësimin e nevojave për mallra e shërbime, ka zhvilluar procedura prokurimi bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

#### **Për vitin 2014;**

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 3/b, kreu I, Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresën nr. 121 prot, datë 21.01.2014, ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, Regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2014, dhe me shkresën nr.110prot, datë 16.01.2015 është dërguar regjistri i realizimit.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike për procedurat e prokurimit procedurat e prokurimit tendera si dhe procedurat e blerjeve me vlera të vogla, për lidhjen dhe zbatimin e kontratave publike bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e vënë në dispozicion u konstatua se:

Për periudhën objekt auditimi 01.07.2014-30.06.2017 Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ka realizuar procedurat si më poshtë vijon;

-Për periudhën nga data 01.07.2014-31.12.2014 janë kryer 2 procedura prokurimi në vlerën totale me fond limit prej 2,905,333 lekë pa tvsh, ose 2,764,518 lekë me tvsh. Nga procedurat e zhvilluara janë kryer 1 procedurë prokurimi me “Procedurë të hapur” me fond limit në vlerën 1,250,000 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 793,000 lekë me tvsh, 1 procedurë “Me negociim pa shpallje” me fond limit në vlerën 1,655,333 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 1,971,518 lekë me tvsh.

-Në lidhje me procedurat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla për periudhën e auditimit në 6-mujorin e dytë të vitit 2104 janë kryer 124 procedura në vlerën totale të fondit limit 13,499,081 lekë pa tvsh., dhe në zbatim në vlerën 16,178,078 lekë me tvsh. Referuar regjistrin vjetor të realizimeve janë kryer 98 procedura në rrugë shkresore, në vlerën totale të fondit limit 12,890,533 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 15,468,640 lekë.

1. Në lidhje me procedurën e prokurimit: “Me negociim pa shpallje”, me objekt “Shërbime e riparime automjeteve VIP”, për vitin 2014;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr. 1239 prot, dt 05.02.2014. -Fondi limit pa tvsh 1,643,333 lekë -Fondi limit me tvsh 1,971,999 lekë -Proc. e Prok. (Me negociim pa shpallje) -Data e zhvillimit të tenderit 11.07.2014 -Subjekti fitues “██████████” sh.p.k. -Data e lidhjes së kontratës 17.07.2014 -Vlera e kontrat pa TVSH 1,620,000 lekë -Vlera e kontratës me TVSH 1,944,000 lekë	Kryetare ██████████ Anëtare ██████████ Anëtar	██████████ Kryetar ██████████ Anëtare ██████████ Anëtare
	Urdhri nr. 1239 prot, datë 05.02.2014	Urdhri nr. 1239/1prot, datë 03.07.2014

-Kjo procedurë është ndjekur nga Autoriteti Kontraktor pasi janë kryer 2 procedura të rregullta prokurimit me “Tender të Hapur” për të cilat nuk është arritur të shpallet asnjë operator fitues, të cilat janë anuluar për shkaqe të arsyeshme.

-Me shkresën nr. 1232 prot, datë 02.07.2014, është bërë kërkesë nga Drejtoria e Planifikimit, për shërbimin e riparimit të automjeteve të Institucionit të Presidentit, me fond limit 1,972,000 lekë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

-Me shkresën nr. 1239 prot, dt 03.07.2014, është hartuar urdhëri i prokurimit, në të cilin janë caktuar dhe anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

-Me shkresën nr. 1239/1 prot, me datë 03.07.2014, është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

-Me shkresën nr. 1239/2 prot, datë 03.07.2014 është dërguar ftesë për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi operatorit ekonomik “██████████” me të dhënat përkatëse. Me shkresën nr. 1239/2 prot, datë 03.07.2014 është dërguar ftesë për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi operatorit ekonomik “██████████” dhe me shkresën nr. 1239/2 prot, datë 03.07.2014 është dërguar ftesë për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi operatorit ekonomik “██████████” sh.a.

Është mbajtur procesverbal mbi hartimin e specifikimeve teknike, kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, nga anëtarët e NJP.

Me shkresën nr. 1239/4 prot, datë 14.07.2014 është hartuar raport i anëtarëve të KVO në të cilin shprehen se ka marrë pjesë vetëm një OE dhe konkretisht “██████████” sh.p.k., me Nipt K5140501P, me ofertë ekonomike në vlerën 1,620,000 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 1239/5 prot, me datë 17.07.2014, është hartuar dhe dërguar për publikim në buletin e APP-së, formulari i njoftimit të fituesit.

-Me nr. 1239/6 prot, me datë 25.07.2014, është hartuar dhe lidhur kontrata midis Instiucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Operatorit Ekonomik “██████████” sh.p.k.

Vlera e kontratës është 1,620,000 lekë pa TVSH, dhe 1,944,000 me afat deri me 31.12.2014.

Me shkresën nr. 1239/7 prot, datë 01.08.2014, është dërguar APP-së njoftimi i lidhjes së kontratës, për publikim.

-Në lidhje me zbatimin e kontratës u konstatua se nga titullari i AK është ngritur komision për ndjekjen dhe realizimin e saj, me urdhërin nr. 1239/8 prot, me datë 01.08.2014.

#### ***Për vitin 2015;***

Regjistri i Parashikimeve të prokurimeve publike është dërguar me shkresën nr. 325 prot, datë 09.02.2015 konform afateve ligjore të përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik. Gjithashtu nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor është dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik me shkresën nr. 91 prot, datë 19.01.2016, regjistri i realizimit të prokurimeve publike.

-Për periudhën 01.01.2015-31.12.2015 Institucioni, ka realizuar 9 procedura prokurimi në vlerën totale me fond limit prej 17,66,937 lekë pa tvsh, ose 21,212,324 lekë me tvsh. Vlera e zbatimit të kontratave është 20,751,692 lekë me tvsh. Nga procedurat e zhvilluara janë kryer 4 procedura prokurimi me “Procedurë të drejtëpërdrejtë” me fond limit në vlerën 1,010,271 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 1,010,271 lekë me tvsh, 4 procedura “Me negociim pa shpallje” me fond limit në vlerën 9,166,666 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 10,741,421 lekë me tvsh, 1 procedurë “E Hapur” me fond limit në vlerën 7,500,000 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 9,000,000 lekë me tvsh.

-Gjithashtu për vitin 2015 janë kryer 418 procedura prokurimi për blerje me vlerë të vogël, në vlerën totale të fondit limit 46,308,120 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 55,041,703 lekë. Nga këto procedura janë kryer 11 procedura prokurimi “Me vlerë të vogël” në rrugë elektronike në vlerën me fond limit 3,990,756 lekë pa tvsh., dhe zbatuar në vlerën 4,260,868 lekë me tvsh. Janë kryer 28 procedura “Emergjente” me fond limit 319,804 lekë pa tvsh dhe janë zbatuar në vlerën 383,764 lekë me tvsh. Janë kryer 379 procedura me vlerë të vogël në shumën 41,997,560 lekë pa tvsh., dhe zbatuar në shumën 50,397,071 lekë me tvsh. Këto procedura sipas NJP-it janë kryer në zbatim të VKM-në nr. 358 datë 24.04.2013 “Për mënyrën e prokurimit të mallrave punëve dhe shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar”, dhe këto procedura nuk zhvillohen me mjete elektronike. Bazuar në VKM-në e mësipërme citohet në pikën 2 se, “Prokurimet për këtë kategori i nënshtrohen procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, sipas dispozitave të legjislacionit për prokurimin publik. Nëse vlera e përlllogaritur për artikuj apo grup artikujsh,



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

*brenda një viti kalendarik, është nën kufirin e ulët monetar”, pra nuk është proceduar në përputhje me legjislacionin e mësipërm.*

-Referuar regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2015 është tejkaluar fondi limit për 2-grup mallra të njëjta ku fondi ka qënë në total më i lartë se kufiri i ulët monetar i cili është përcaktuar në vlerën 8,000,000 lekë pa tvsh, kjo pasi për për zërin “Udhëtim jashtë shtetit + dieta + bileta avioni + charter”, vlera totale e fondit limit të prokuruar ka qënë 18,000,000 lekë dhe është zbatuar në vlerën 11,843,533 lekë, në zërin “Pritje e përcjellje delegacionesh, dreka e darka, kredenciale”, e cila është llogaritur në vlerën e fondit limit 11,029,000 lekë pa tvsh dhe është realizuar në vlerën 11,029,000 lekë me tvsh, në kundërshtim me VKM-në Nr. 358 datë 24.04.2013 “Për mënyrën e prokurimit të mallrave punëve dhe shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar”, pika 2.

2. Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti benzinë, naftë për automjetet e institucionit dhe kaldajën e gjeneratorin”, për vitin 2015;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr. 477/6 prot, dt 06.03.2015. -Fondi limit pa tvsh 7,500,000 lekë -Fondi limit me tvsh 9,000,000 lekë -Proc. e Prok. (E Hapur) -Data e zhvillimit të tenderit 03.04.2015 -Subjekti fitues “██████████” sh.p.k -Data e lidhjes së kontratës 02.05.2015 -Vlera e kontrat pa TVSH 7,500,000 lekë -Vlera e kontratës me TVSH 9,000,000 lekë -Marzhi i fitimit 7.8%/litër me TVSH benzina dhe 6.8%/litër me TVSH nafta	██████████ Kryetare ██████████ Anëtare ██████████ Anëtar  Urdhri nr. 477/6 prot, dt 06.03.2015	██████████ Kryetar ██████████ Anëtare ██████████ Anëtare  Urdhri nr.477/7 prot, dt 06.03.2015

Me shkresën nr. 477 prot, datë 26.02.2015, është bërë kërkesë nga Drejtoria e Planifikimit, e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili me shkresën nr. 477/ 4 prot, datë 04.03.2015, ka urdhëruar grupin e punës për llogaritjen e fondit limit.

Me shkresën nr.477/1 prot, me datë 27.02.2015, kërkesa dërguar Institutit të Statistikave, me anë të së cilës Institucioni i Presidentit të Republikës, i kërkon të dhëna mbi çmimet e Karburantit benzinë dhe diesel, dhe me shkresën nr. 477/10 prot, me datë 13.03.2015 i është kthyer përgjigje nga INSTAT-i me çmimet e mallrave të kërkuar.

-Me shkresën nr. 477/6 prot, dt 06.03.2015 është krijuar komisioni i Njesisë së Prokurimit.

-Me shkresën nr.477/5 prot, me datë 06.03.2015, është bërë përlllogaritja e fondit limit nga Komisioni dhe vlera e përlllogaritur është 7,500,000 lekë pa tvsh ose 9,000,000 lekë me tvsh, fond i cili është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

-Me shkresën nr. 477/7 prot, me datë 06.03.2015, është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

-Me shkresën nr.477/8 prot, datë 09.03.2015, nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit është mbajtur procesverbal mbi hartimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “E hapur”, për tenderin me objekt Blerje karburanti benzinë, naftë për automjetet e institucionit dhe kaldajën e gjeneratorin”, për vitin 2015.

-Me shkresën nr. 477/9, datë 10.03.2015 është hartuar dhe dërguar për publikim formulari i njoftimit të kontratës i cili përmban të dhënat sipas kërkesave të AK-së.

-Me shkresën pa nr. prot, me datë 03.03.2015 është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, kualifikimit dhe s’kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ku kanë praqitur dokumentet 2 OE si më poshtë:



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Për Lotin I-Blerje Benzinë;

1. Operatori ekonomik Bashkim Operatorësh “██████████” sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 7.8%/litër.
2. Operatori ekonomik “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike 9.43%/litër.

Për Lotin II-Blerje Naftë;

1. Operatori ekonomik Bashkim Operatorësh (BO) “██████████” sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 6.8%/litër
2. Operatori ekonomik “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike 8.44%/litër.

Të dy operatorët ekonomikë janë kualifikuar për fazën tjetër, duke klasifikuar si fitues OE, për Lotin I-rë dhe Lotin II-të (BO) “██████████” sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 7.8%/litër për benzinën dhe me marzh fitimi 6.8%/litër për naftën.

-Njoftimi i fituesit është shpallur në buletin nr. 18, datë 11 Maj 2015.

-Me nr. 477/1 prot, me datë 12.05.2015, është hartuar dhe lidhur kontrata midis Instiucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “██████████” sh.p.k., Durrës.

Vlera e kontratës është Loti i I-rë benzinë në shumën 4,800,000 lekë pa TVSH, me marzh fitimi 7.8%/litër dhe Loti i II-të naftë në shumën 2,700,000 lekë pa TVSH, me marzh fitimi 6.8%/litër me afat deri me 31.12.2015.

-Është plotësuar dhe paguar sigurimi i kontratës në Subjektin ██████████, referuar faturës me nr. 14948055 serial, datë 06.05.2016, nga OE fitues në shumën 324,000 lekë për Lotin e II-të blerje naftë, dhe referuar faturës me nr. 14948056 serial, datë 06.05.2016, në shumën 576,000 lekë për Lotin e I-rë blerje benzinë.

-Në lidhje me zbatimin e kontratës u konstatua se nga titullari i AK është ngritur komision për ndjekjen dhe realizimin e saj, me urdhërin nr. 477/14 prot, me datë 20.05.2015.

-Referuar pagesave të kryera për këtë kontratë rezultoi se përlogaritja është kryer konform kontratës nga OE, në bazë çmimeve të buletinit në datën e fundit te publikuar, sipas faturës së tvsh-së, dhe marzhit të fitimit.

**Për vitin 2016**, sipas Regjistrit të Parashikimeve për prokurime, dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik konform afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik, me shkresën nr.149, datë 27.01.2016, Institucioni i Presidentit të Republikës ka parashikuar prokurime publike për zërin “Tendera”, në vlerën 14,595,600 lekë me tvsh, për 5(pesë) procedura prokurimi gjithsej dhe ka realizuar 13,089,152 lekë me tvsh, konfirmuar me Regjistrin e Realizimeve dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik me shkresën nr.85, datë 18.01.2017. Institucioni i Presidentit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka zhvilluar si procedurë prokurimi në 2 (dy) raste “*procedurë e hapur*”, në 1(një) rast “*me negociim pa shpallje*” si dhe procedurë prokurimi “*të drejtëpërdrejtë*”. Nga vlera e prokuruar 14,595,600 lekë janë realizuar 13,089,152 lekë duke kursyer në këtë mënyrë 1,506,448 lekë.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike për procedurat e prokurimit procedurat e prokurimit tendera si dhe procedurat e blerjeve me vlera të vogla, për lidhjen dhe zbatimin e kontratave publike bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e vënë në dispozicion u konstatua se:

Për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016, Institucioni ka realizuar procedurat si më poshtë vijon:

Janë realizuar 5 procedura prokurimi (tendera) në shumën totale me fond limit prej 12,163,000 lekë pa tvsh, ose në vlerën 14,595,600 lekë me tvsh. Shuma e zbatimit të kontratave është në vlerën 13,089,152 lekë me tvsh. Nga procedurat e zhvilluara janë kryer 2 procedura prokurimi me “*Procedurë të drejtë për drejtë*” me fond limit në shumën 1,143,000 lekë pa tvsh., dhe zbatuar në





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

vlerën 1,143,000 lekë me tvsh., 1 procedurë “*Me negociim pa shpallje*” me fond limit në vlerën 186,000 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 214,272 lekë me tvsh, 2 procedura “*E Hapur*” me fond limit në vlerën 10,834,000 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 11,731,880 lekë me tvsh.

1. Në lidhje me procedurën e prokurimit: “*Procedure e hapur*”, me objekt “Blerje karburanti (benzinë, naftë) për automjete”, **për vitin 2016**;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vlerësimit të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr. 462/1 prot, dt 02.03.2016. -Fondi limit pa tvsh 6,667 000 lekë -Fondi limit me tvsh 8,000,400 lekë -Proc. e Prok. (E Hapur) -Data e zhvillimit të tenderit 25.03.2015 -Subjekti fitues “██████████”sh.p.k -Data e lidhjes së kontratës 19.04.2016 -Vlera e kontratës pa TVSH 6,667,000 lekë -Vlera e kontratës me TVSH 8,000,400 lekë -Marzhi i fitimit 9.6%/litër me TVSH benzina dhe 8.6 % /litër me TVSH naftë	██████████ Kryetare ██████████ Anëtare ██████████ Anëtar  Urdhri nr. 462/1 prot, dt 02.03.2016	██████████ Kryetar ██████████ Anëtare ██████████ Anëtare  Urdhri nr.462/10 prot, dt 19.04.2016

a) *Mbi argumentimin e nevojave dhe llogaritja e fondit limit*

Autoriteti Kontraktor në llogaritjen e vlerësimit të kontratës, i është referuar kërkesave të kreut II, pika 2/c të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti (benzinë, naftë) për automjete”, për vitin 2016, konstatohet se Autoriteti Kontraktor në kërkesën e tij drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe INSTAT, ka kërkuar standardet për karburantet si dhe çmimet nga INSTAT.

Me shkresën nr. 462 prot, datë 02.03.2016, është bërë kërkesë nga Drejtorja e Planifikimit dhe Menaxhimit, e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili me shkresën nr. 462/1 prot, datë 02.03.2016, ka urdhëruar ngritjen e njësisë së prokurimit.

Mbi kërkesën për blerje karburanti të Drejtorisë së Shërbimeve, kemi një analizë të thjeshtë të tyre pasi jepen të dhëna për sasi të litra për benzinë dhe naftë, pa bërë analizën e konsumit të karburantit për km dhe për automjet sipas tipit dhe karburantit që konsumon.

b) *Zhvillimi i procedurës së prokurimit*

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali për miratimin e DST të tenderit sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2/a, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Me shkresën nr. 462/2, datë 02.03.2016 është hartuar dhe dërguar për publikim formulari i njoftimit të kontratës i cili përmban të dhënat sipas kërkesave të AK-së.

- Me shkresën nr. 462/4 prot, me datë 23.03.2016, është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

- Me shkresën nr. 462/5 prot, me datë 31.03.2016 është mbajtur aktverifikimi mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura, kualifikimit dhe s’kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ku kanë paraqitur dokumentet 2 OE si më poshtë:

Për Lotin I - “Blerje Benzinë”;

3. Operatori ekonomik Bashkim Operatorësh “██████████”sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 9.6% për litër litër.

4. Operatori ekonomik “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike 9.9% për litër.

Për Lotin II - “Blerje Naftë”;



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

3. Operatori ekonomik Bashkim Operatorësh (BO) “██████████” sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 8.6% për /litër
4. Operatori ekonomik “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike 8.86%/ për litër.

Të dy operatorët ekonomikë janë kualifikuar për fazën tjetër, duke klasifikuar si fitues OE, për Lotin I-rë dhe Lotin II-të (BO) “██████████” sh.p.k., dhe “██████████” sh.a., me ofertë ekonomike me marzh fitimi 9.6% për litër për benzinën dhe me marzh fitimi 8.6% për litër për naftën.

Pas auditimit u konstatua se dokumentat e paraqitura nga operatori fitues ishin në përputhje me dokumentat standarde të tenderit.

#### c) *Lidhja, zbatimi i kontratës dhe marra në dorëzim.*

Pas shpalljes së fituesit për 2 lotet, është lidhur kontrata me OE përkatës dhe konkretisht kontrata me nr. 462/9 prot, me datë 18.04.2016, me OE “██████████” sh.p.k., Durrës, me objekt “blerje nafte dhe benzine”.

Vlera e kontratës është Loti i I-rë benzinë në shumën 3,933,530 lekë pa TVSH, me marzh fitimi 9.6% për litër dhe Loti i II-të naftë në shumën 2,733,470 lekë pa TVSH, me marzh fitimi 8.6% për litër me afat deri me 31.12.2016.

- Në lidhje me zbatimin e kontratës u konstatua se nga titullari i AK është ngritur komision për ndjekjen dhe realizimin e saj, me urdhrin nr. 462/10 prot, me datë 19.04.2016.

Nga momenti i lidhjes së kontratës deri në datën e mbarimit të kësaj kontrate janë likuiduar 8,000,000 lekë për blerje nafte dhe benzine.

**Për vitin 2017, në periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 30.06.2017**, sipas Regjistrisë të Parashikimeve për prokurime, dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik konform afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik, me shkresën nr.179, datë 27.01.2017, Institucioni i Presidentit të Republikës ka parashikuar prokurime publike për zërin “Tendera, shpenzime (602)”, në vlerën 77,914,000 lekë, të ndara respektivisht 62,914,000 lekë në zërin “Mallra dhe Shërbime” dhe 15,000,000 në zërin “Shpenzime kapitale, investime”. Bazuar në regjistrin e realizimit të prokurimeve për për 4 mujorin e parë të vitit 2017 (pasi regjistri për realizimin e prokurimeve hartohet mbi bazë 4 mujori) prokurimet janë realizuar në vlerën 19,461,205 lekë. Gjatë kësaj periudhe është realizuar vetëm 2 (dy) procedura prokurimi, ku autoriteti kontraktor (AK) ka preferuar si procedurë prokurimi “*prokurim i drejtëpërdrejtë*”.

#### **- Procedurat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla**

##### **Për vitin 2016:**

Në lidhje me procedurat e prokurimit për blerjet me vlera të vogla janë gjithësej 512 procedura në vlerën totale të fondit limit 56,115,657 lekë pa tvsh., dhe zbatuar në vlerën 66,852,159 lekë me tvsh. Prej tyre, 7 procedura prokurimi janë kryer në rrugë elektronike në shumën me fond limit 3,552,327 lekë dhe zbatuar në vlerën 3,776,164 lekë me tvsh. Janë kryer 66 procedura “Emergjente” me fond limit në vlerën 893,048 lekë pa tvsh., dhe janë zbatuar në vlerën 1,071,657 lekë me tvsh.

Gjithashtu janë kryer 439 procedura prokurimi me vlerë të vogël në rrugë shkresore, në vlerën totale të fondit limit në vlerën 51,670,282 lekë pa tvsh dhe zbatuar në vlerën 62,004,338 lekë.

#### **IV.5. Krijimi dhe Përdorimi i të ardhurave**

##### **5.1. Të ardhurat nga buxheti i shtetit.**

**- Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të vitit 2014, 2015 dhe 2016, 2017 çelja e detajimi i planit fillestar, ndryshimet e tij gjatë vitit dhe zbatimi i tij.**



Institucioni i Presidentit, bazuar në programin buxhetor afatmesëm dhe në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 22.02.2013 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016”, VKM nr.138, datë 20.02.2013 “Mbi miratimin e taveve përgatitore të PBA-së 2014-2016”, ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këto udhëzime.

Janë ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programeve ( për vitin 2014 me Urdhër të Brendshëm nr. 11, datë 07.04.2014, për vitin 2015 me Urdhër të Brendshëm nr. 6, datë 16.04.2015 i cili ka qenë i njëjtë edhe për vitin 2016; për vitin 2017 është ngrit me Urdhër të Brendshëm nr. 881, datë 31.04.2017) dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me Urdhër të Brendshëm nr. 880, datë 31.03.2017 .

Konkretisht për vitin 2014 :

Nga auditimi i programimit për vitin 2014, konstatoam se PBA e Presidencës është hartuar në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 22.02.2012 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016”, si dhe VKM-së nr.138, datë 20.02.2013 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetore Afatmesëm 2014-2016”, po ashtu u konstata se kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA- së janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 874 datë 30.04.2013 dhe fazën e dytë me shkresën nr. 1609 prot, datë 26.08.2013.

Për vitin 2015 :

Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017”, si dhe VKM-së nr.110, datë 27.02.2014 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetore Afatmesëm 2015-2017”, Presidenca ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.437/1 datë 23.04.2014me “Dërgohen kërkesat buxhetore të Institucionit të Presidentit për fazën e parë të PBA-së 2015-2017” dhe për fazën e dytë me shkresën nr. 1528 prot., datë 21.08.2015.

Për vitin 2016:

Në zbatim të Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 27.02.2015 ”Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018”, Presidenca ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht, me shkresën nr. 893 prot., datë 29.04.2015 “Dërgohen kërkesat buxhetore të Institucionit të Presidentit për fazën e parë të PBA-së 2016-2018”, brenda aftit ligjor që është deri më datë 01 Maj 2015. Dhe për fazën e dytë kërkesat buxhetore përfundimtare janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1521 prot., datë 25.08.2015.

Për vitin 2017:

Në zbatim të Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.4, datë 29.02.2016 ”Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”,

Presidenca ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht, me shkresën nr. 472/1 prot., datë 29.04.2016 “Dërgohen kërkesat buxhetore të Institucionit të Presidentit për fazën e parë të PBA-së 2016-2018”, brenda aftit ligjor



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

që është deri më datë 01 Maj 2015. Dhe për fazën e dytë kërkesat buxhetore përfundimtare janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht, me shkresën nr. 1497/1 prot, datë 25.08.2016

Zbatimi i buxhetit gjatë vitit 2014, 2015, 2016, dhe 6 mujori 2017 dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Zbatimi i buxhetit mbështetet në ligjin e buxhetit vjetor, shkresat e Ministrisë së Financave për akordimin e tyre, si dhe në udhëzimet për zbatimin e tij nga Ministria e Financave që del çdo vit. Nga Dega e Buxhet-Financës ndiqet realizimi i buxhetit për çdo muaj, sipas evidencave të dërguara. Për një menaxhim sa më të mirë të buxhetit, ose në rastet e rishikimit të tij me ligj kryhen rishpërndarjet e fondeve në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimet e miratuara nga Ministri i Financave.

Janë zbatuar kriteret e programimit të buxhetit, respektimi i limitit të fondeve dhe përdorimi i të ardhurave nga fondet kundër parti.

Për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, janë hartuar projekt dhe planet e buxheteve të cilat i janë dërguar Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave.

Ndarja e plan buxheteve dhe detajimet e tyre janë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli dhe është respektuar disiplina buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Janë respektuar procedurat për programimin e buxhetit dhe çeljen e fondeve në Degën e Thesarit. Treguesit e buxhetit, janë mbajtur tek llogaria e Thesarit.

Për vitin 2014.

Me ligjin nr. 185/2013 datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Institucionit të Presidentit i janë akorduar fonde në shumën totale prej 183,200,000 lekë, nga të cilat 178,200,000 për shpenzime korrente dhe 5,000,000 për shpenzime kapitale. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit.

Krahasuar me fondet e çelura në fillim viti, rezulton se për vitin 2014 ka pasur ndryshime në fondet buxhetore me kërkesë të vet Institucionit si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.808 datë 26.11.2014.

Në fund të vitit 2014, krahasuar me planin përfundimtarparaqiten me realizim programet siç do ti shohim edhe më poshtë.

Bashkëlidhur projektbuxhetit janë vendosur dhe formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Në fakt projektbuxheti i Institucionit të Presidentit është dërguar dhe mbrojtur në Ministrinë e Financave në masën e nevojave të tij, po ashtu dhe akordimi ka qenë në referencë të tavaneve dhe limiteve të vendosura dhe miratuara nga Këshilli i Ministrave referuar PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm).

Me shkresën nr. 15, datë 08/01/2014 është dërguar detajimi i plan buxhetit për vitin 2014, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 19405/53, datë 10/01/2014. Me shkresën nr. 2297/1 datë 03.03.2014 është dërguar detajimi i plan buxhetit për investime.

Institucioni i Presidentit gëzon statusin e institucionit plotësisht buxhetor. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit. Është për t'u theksuar se totali i fondeve për investime në këtë institucion i çelur për vitin 2014 referuar ligjit të mësipërm është në vlerën 5,000,000 lekë ose në masën 2.7% të totalit të fondeve buxhetore. Pësha e investimeve të realizuar për vitin 2014 zë rreth 2.5% të totalit të buxhetit.

Buxheti vjetor për 2014 për këtë institucion është në masën 99% ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Buxheti vjetor i planifikuar, i rishikuar, ishte në masën e 186,730,000 lekë dhe realizimi faktik është në masën e 185,905,732lekë, si më poshtë:

Në lekë

<i>Buxheti fillestar</i>	<i>Nr.llog</i>	<i>Buxheti fillestar</i>	<i>Plani përfundimtar pas rishikimit</i>	<i>Realizimi faktik</i>	<i>Përqindja e realizimit ndaj planit</i>
Pagat	600	84,000,000	79,102,346	78,993,984	99.8%
Kontrib.e sig shoqërore e shendet	601	15,500,000	11,400,000	11,264,224	98.8%
Mallra dhe shërbime	602	72,000,000	89,200,000	89,108,790	99.9%
Transfer.korrente të huaja	604		280,000	280,000	100%
Transferta për buxhete familje & individ.	606	6,700,000	1,747,654	1,576,638	90.2%
Shpenzime kapitale të trupëzuara	231	5,000,000	5,000,000	4,682,096	93.6%
<b>Totali</b>		<b>183,200,000</b>	<b>186,730,000</b>	<b>185,905,732</b>	<b>99.6%</b>
<i>Jashtë buxhetore</i>		<i>975,460</i>	<i>975,460</i>	<i>870,000</i>	
<b>Total + jashtë buxhetore</b>		<b>184,175,460</b>	<b>187,705,460</b>	<b>186,775,732</b>	<b>99.5%</b>

Konstatohet se rreth 42% të totalit të buxhetit të realizuar gjatë 2014 e zënë shpenzimet për “Paga”, 6% e zënë shpenzimet për “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, 48% “Shpenzime për mallra dhe shërbime” dhe pjesa tjetër llogarive zë një peshë shumë më të vogël, konkretisht: “Transferta korrente të brendshme” zënë 0.15% të totalit të buxhetit faktik, “Transferta për buxhete familje, dhe individ” zënë 0.01% të totalit të buxhetit dhe “shpenzime kapitale të trupëzuara” zënë 0.03%.

Realizimi i buxhetit, në të gjitha programet e Institucionit, vlerësohet si relativisht i mirë, duke paraqitur një performancë të mirë në realizimin e shpenzimeve, gjykuar nga realizimi i tyre në vlerë dhe përqindje. Konkretisht përqindja e realizimit të buxhetit faktit me 99.5% detajuar në realizimet respektive të secilës llogari janë si vijon: llogaria 604 “Transferta korrente të brendshme” ka dhe nivelin e realizimit më të lart me 100%, pas tij vijon llogaria 600 “Paga” me 99,8%; vijon llogaria 602 “Mallra dhe shërbime” me një realizim prej 99% ndaj planit, më pas është llogaria “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetësore” me një nivel realizimi prej 98.8%; llogaria 231 “shpenzime kapitale të trupëzuara” e cila është realizuar në nivelin 93.6% dhe në fund llogaria 606 “Transferta për buxhete familje dhe individë” me nivel realizimi më të ulët prej 90.2%.

Në vitin 2014 konstatohen ndryshime të realizuara mbi buxhetin, që kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve me VKM si dhe me kërkesa të vet institucionit, të dhënat paraqiten si më poshtë:

<i>VITI 2014</i>		<i>Në lekë</i>
<i>Art.</i>		<b>Ndryshime</b>
	<b>E M E R T I M I I PROGRAMIT</b>	
<b>600</b>	<b>Paga</b>	<b>-4,897,654</b>
		-1,200,000
		-3,400,000
		-297,654
<b>601</b>	<b>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</b>	<b>-4,100,000</b>
		-4,100,000
<b>602</b>	<b>Shpenzime Operative</b>	<b>17,200,000</b>
		6,700,000
		7,500,000





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

		3,000,000
<b>604</b>	<b>Transferta korrente të brendshme</b>	<b>280,000</b>
		280,000
<b>606</b>	<b>Trans per Buxhete Familjare&amp; Individ</b>	<b>-4,952,346</b>
		1,200,000
		30,000
		-6,700,000
		140,000
		297,654
		50,000

Përsa i përket detajimit të shkresave përkatëse për ndryshimet e kryera gjatë gjatë vitit buxhetor përmbledhtazi janë si më poshtë vijon:

Artikuj					600	601	602	604	606
Shkresa e Institucionit		Ministria e Fincancës							
282	10.02.2014	1688/1	14.02.2014		-1,200,000				1,200,000
360	20.02.2014	2380/1	25.02.2014						30,000
645	02.04.2014	4604/1	09.04.2014				6,700,000		-6,700,000
774/1	25.04.2014	6284/1	30.04.2014						30,000
866/1	12.05.2014	7124/1	16.05.2014						140,000
1136	20.06.2014	9231/2	24.06.2014		-3,400,000	-4,100,000	7,500,000		
1805	01.10.2014	13486/1	06.10.2014		-297,654				297,654
1972/1	22.10.2014	14597/1	27.10.2014						50,000
2081/1	05.11.2014	15234/1	19.11.2014					280,000	
VKM Nr. 808 datë 26.11.2014	2259	02.12.2014	13647/5	04.12.2014			3,000,000		

Për vitin 2014u konstatua se përveç ndryshimeve të kryerja në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.808 datë 26.11.2014 ndryshimet e tjera kanë ardhur si rrjedhojë e nevojës së rishikimit të objektivave duke i dhënë prioritet realizimit sa më të mirë të qëllimit të politikës së vet Institucionit, si dhe për shkak të nevojave për raste të përdorimit të fondit të veçantë.

Po ashtu u konstatua se në dokumentacion ishin prezent formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Referuar realizimit të produkteve raportuar në raportin e monitorimit dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.133 prot, datë 20.01.2015

Nga realizimi i buxhetit në fund të vitit konstatohet një diferenc pozitive, e cila kalohet në buxhet të shtetit drejtpërdrejt nga thesari.

Artikulli	Emërtimi	Totali i Shpenzimeve Janar- Dhjetor 2014			
		Buxheti Janar- Dhjetor	Fakti Janar- Dhjetor	Diferenca Janar- Dhjetor	Realizimi ne %
6009999	Shpenzime personeli	90,502,346	90,258,208	244,138	99.7
6029999	Shpenzime te tjera	91,227,654	90,965,428	262,226	99.7
	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>181,730,000</b>	<b>181,223,636</b>	<b>506,364</b>	<b>99.7</b>
231	Kapitale te Trupezuara	5,000,000	4,682,096	317,904	93.6
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>186,730,000</b>	<b>185,905,732</b>	<b>824,268</b>	<b>99.6</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

602	Jashtë buxhe tore	975,460	870,000	105,460	89.2
<b>Totali</b>	<b>Korrente + kapitale + Jashtë buxhetore</b>	<b>187,705,460</b>	<b>186,775,732</b>	<b>929,728</b>	<b>99.5</b>

Sa shihet nga tabela më sipër, Institucioni ka bërë një punë të mirë duke realizuar plotësisht objektivat e parashikuara për vitin 2014, si edhe duke realizuar shpenzimet totale të vitit në masën 99.5%, çka tregon një përdorim të mirë të fondeve të akorduara.

Duke analizuar zërat e shpenzimeve, shohim:

“Shpenzimet e Personelit”, plani fillestar ishte 99,5 milion lekë, u bënë dy ndryshime gjatë vitit, u kaluan fondet për pagesën e listës së pritjes në llogarinë ekonomike “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, në zbatim të udhëzimit nr. 3, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, si edhe u rialokuan 7,5 milion lekë në llogarinë e shpenzimeve operative, për të mundësuar realizimin e objektivave të rëndësishme të Institucionit. Shpenzimet e personelit u realizuan në masën 99.7%, që tregon për një realizim optimal të këtyre shpenzimeve.

“Shpenzimet të tjera korrente”, i cili përbëhet nga zërat “Mallra dhe Shërbime”, “Transferta korrente të brendshme” dhe “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, janë realizuar thuajse plotësisht, në masën 99.7%, duke realizuar kështu objektivat dhe produktet e parashikuara për veprimtarinë e Institucionit. Fondet e këtij grupi shpenzimesh u shtuan nga 78,7 milion lekë, në 91,2 milion lekë, duke përdorur fondet e vet Institucionit, për të përmbushur objektivat dhe produktet e parashikuara në veprimtarinë e Presidentit të Republikës.

Për sa i përket “Shpenzimeve kapitale”, fondet janë realizuar në total në masën 93.6%. Fondet janë parashikuar në dy projekte: në “Rikonstrukcion të rrethimit të institucionit” dhe në “Blerje pajisje e orendi zyrash”. Sipas projekteve, shpenzimet janë realizuar përkatësisht 75% dhe 98%, duke përfunduar kështu objektivat e caktuara.

Në “Shpenzimet jashtë buxhetore”, përfshihen fonde nga sponsorizime të trashëguara nga viti 2013, por edhe të krijuara këtë vit, të cilat janë përdorur sipas kontratave të lidhura.

Për vitin 2015.

Me ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, Institucionit të Presidentit i janë akorduar fonde në shumën totale 186,500,000 lekë, nga të cilat 176,500,000 për shpenzime korrente dhe 10,000,000 për shpenzime kapitale. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit.

Krahasuar me fondet e çelura në fillim viti, rezulton se ky institucion për vitin 2015 ka pasur ndryshime në fondet buxhetore me Vendim të Këshillit të Ministrave, me Akte Normative si dhe me kërkesë të vet institucionit.

Në fund të vitit 2015, krahasuar me planin përfundimtar paraqiten me realizim të gjithë programet siç do ti shohim edhe më poshtë.

Bashkëlidhur projektbuxhetit janë vendosur dhe formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Në fakt projektbuxheti i Institucionit të Presidentit është dërguar dhe mbrojtur në Ministrinë e Financave në masën e nevojave të institucionit, po ashtu dhe akordimi ka qenë në referencë të tavaneve dhe limiteve të vendosura dhe miratuara nga Këshilli i Ministrave referuar PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm).

Me shkresën nr. 2475 datë 30.12.2014 është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente për vitin 2015, miratuar me shkresën nr. 18082/75, datë 07/01/2015 të Ministrisë së Financave si dhe detajimi i buxhetit për investime miratuar me shkresën 140/46 datë 16.01.2015.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Institucioni i Presidentit gëzon statusin e institucionit plotësisht buxhetor. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit.

Buxheti vjetor për 2015, i planifikuar për këto artikuj, është realizuar në masën 99.7% ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti planifikuar vjetor ishte në masën e 194,583,280 lekë dhe realizimi faktik është në masën e 193,979,647lekë, si më poshtë:

Në lekë

Buxheti fillestar	Nr.llog	PBA kërkesa e institucionit		Buxheti Fillestar i akorduar	Plani përfundimtar pas rishikimit	Realizimi faktik	Përqindja e realizimit ndaj planit
		Faza e parë	Faza e dytë				
Pagat	600	85,000,000	85,000,000	85,000,000	82,982,153	82,770,451	99,7%
Kontrib.e sig shoqërore shendet	601	15,000,000	15,000,000	14,500,000	11,700,000	11,611,277	99,2%
Mallra dhe shërbime	602	72,000,000	72,000,000	77,000,000	87,750,000	87,745,534	99,9%
Transfer.korrente të brendshme	604				942,413	942,413	100%
Transfer.korrente të huaja	605				0	0	
Transferta për buxhete familje & individ.	606				208,714	176,847	84.7%
Shpenzime kapitale të trupëzuara	231	5,000,000	5,000,000	10,000,000	10,406,180	10,139,305	97.4%
Shpenzime kapitale të patrupëzuara	230				593,820	593,820	100%
<b>Totali</b>		<b>176,894,540</b>	<b>186,499,990</b>	<b>186,499,990</b>	<b>194,583,280</b>	<b>193,979,647</b>	<b>99.7%</b>
Jashtë buxhetore		105,460	105,460	105,460			
<b>Totali + jashtë buxhetore</b>		<b>177,000,000</b>	<b>186,605,460</b>	<b>186,605,460</b>	<b>194,583,280</b>	<b>193,979,647</b>	

Konstatohet se rreth 42% të totalit të buxhetit të realizuar gjatë 2016 e zënë shpenzimet për “Paga”, 6% e zënë shpenzimet për “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, 45% “Shpenzime për mallra dhe shërbime” dhe 5% “Shpenzimet kapitale të trupëzuara” dhe pjesa tjetër llogarive zë një peshë shumë më të vogël, konkretisht: “Transferta korrente të brendshme” zë 0.5% ; “Transferta për buxhete familje dhe individ.” 0.09% dhe “shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara” 0.3%.

Realizimi i buxhetit, në të gjitha programet e Institucionit, vlerësohet si relativisht i mirë, duke paraqitur një performancë të mirë në realizimin e shpenzimeve, gjykuar nga realizimi i tyre në vlerë dhe përqindje. Konkretisht përqindja e realizimit të buxhetit faktit me 99.7% detajuar në realizimet respektive të secilit artikull janë si vijon: artikulli 604 “Transferta korrente të brendshme” ka dhe nivelin e realizimit më të lart me 100%, pas tij vijon artikulli 602 “Mallra dhe shërbime” me një realizim prej 99,9% ndaj planit, më pas është artikulli 600 “Paga” me 99,7% dhe artikulli 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore” me 99.2% realizim; artikulli 231 “Shpenzime kapitale të trupëzuara” me 97.4% dhe artikulli 606 “Transferta për buxhete familjare dhe individ” me 84.7%

VITI 2015		Në mijë lekë
Art.		Ndryshime
<b>E M E R T I M I I PROGRAMIT</b>		
<b>600</b>	<b>Paga</b>	<b>-2,017,847</b>
		-2,017,847
<b>601</b>	<b>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</b>	<b>2,800,000</b>
		-2,800,000



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

<b>602</b>	<b>Shpenzime Operative</b>	<b>10,750,000</b>
		10,750,000
<b>604</b>	<b>Trans korrente të brendshme</b>	<b>942,413</b>
		942,413
<b>606</b>	<b>Trans per Buxhete Familjare&amp; Individ</b>	<b>208.714</b>
		208.714
<b>231</b>	<b>Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara</b>	<b>1,406,000</b>
		1,000,000
		406,000

Përsa i përket detajimit të shkresave përkatëse për ndryshimet gjatë vitit buxhetor:

Artikuj					600	601	602	604	606	231
	Shkresa e Institucionit		Ministria e Fincancës							
	103	15.01.2015	652/1	2.03.2015				280,000		
	204	28.01.2015	1446/1	27.02.2015				293,280		
vkm 612, 7.07.15	1362	14.07.2015	10625/1	21.07.2015			10,750,000			
akt nor.1, 29.07.15	1484/1	7.08.2015	11546/12	13.08.2015		(1,000,000)				1,000,000
	1558/1	3.08.2015	13411/1	1.10.2015				280,000		
	1682	22.09.2015	13411/1	1.10.2015				280,000		
	1659	18.09.2015	13289/1	22.09.2015	(17,847)				17,847	
	1903	29.10.2015	13441/4	3.11.2015				190,867	190,867	
akt nor.3, 28.12.15	20-Jan	6.01.2016	18004/79	11.01.2016	(2,000,000)	(1,800,000)				

Për vitin 2015 u konstatuan ndryshime të realizuara mbi buxhetin, që kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve me Vendim të Këshillit të Ministrave, konkretisht me VKM Nr.612 datë 07.07.2015, Akte Normative, Akt Normativ Nr.1 datë 29.07.2015 dhe Akt Normativ Nr.3 datë 8.12.2015 si dhe kërkesa të vet Institucionit ardhur si rrjedhojë e nevojës së rishikimit të objektivave duke i dhënë prioritet realizimit sa më të mirë të qëllimit të ploitikës së vet Institucionit.

Po ashtu u konstatua se në dokumentacion ishin prezent formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Referuar realizimit të produkteve raportuar në raportin e monitorimit dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.86 prot, datë 19.01.2016

Analiza e realizimit të objektivave të politikës së programit

Objektivi 1:

Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit nëpërmjet 840 dekretive të ndryshme për shtetësinë shqipëtare, falje, dekorata e tituj nderi dhe shpallje ligjesh.

Ky objektivi është përmbushur në masën 100% dhe produkti është realizuar plotësisht, madje ka tejkalin me 118%.

Objektivi 2:

Të bëhen të njohura vlerat kombëtare, synimet e politikës së jashtme të vendit në interes të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet realizimit të 25 shkëmbimeve të vizitave të Presidentit të Republikës.

Ky objektivi është përmbushur në masën 100% dhe produkti është realizuar plotësisht në masën 100%.

Objektivi 3:



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Të mbështesë e të nxisë vlerat kombëtare si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit nëpërmjet organizimit të 100 veprimtarive kryesore protokollare brenda vendit.

Ky objektivi është nuk është përmbushur pasi fondet e dhëna u alokuan në shpenzime operative, si rrjedhojë e domosdoshmërisë së realizimit të objektivave të tjera të lidhura me këto shpenzime. Produkti është realizuar plotësisht në masën 160%.

Objektivi 4:

Rikonstruksioni dhe mobilimi i sallës VIP.

Ky objektivi është përmbushur plotësisht, në masën 100%.

Konstatohet se, Institucioni ka bërë një punë të mirë duke realizuar shpenzimet totale të vitit në masën 99.7%, që tregon një përdorim të kënaqshëm të fondeve të akorduara.

Si përfundim në lidhje me realizimit e veprimtarisë së Institucionit të Presidentit për vitin 2015 mund të themi se janë realizuar plotësisht objektivat e parashikuara në fillim të vitit, si:

Institucioni ka realizuar plotësisht objektivat e vendosura, si rrjedhojë, janë realizuar dhe tejkaluar produktet e parashikuara në terma sasiorë dhe financiarë, të cilat konsistojnë:

- Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit të Republikës, nëpërmjet 943 dekretiveve të ligjeve, dekretiveve për shtetësinë, dekorata e tituj nderi, nga rreth 840 të planifikuara;
- Njohje e vlerave kombëtare dhe synimeve të politikës së jashtme të vendit, nëpërmjet shkëmbimit të vizitave të Presidentit të Republikës dhe pritjes së personaliteteve të larta shtetërore, 25 aktivitete, nga 25 të planifikuara;
- Mbështetje dhe nxitje e vlerave kombëtare, si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit, nëpërmjet organizimit të rreth 160 veprimtarive protokollare brenda vendit, nga rreth 100 të planifikuara;
- Rikonstruksioni dhe mobilimi i Sallës VIP, duke e përfunduar atë në afatin e parashikuar.

Objektivat e politikës		Niveli i planifikuar	Niveli faktik	% e realizimit të treguesit të performancës
1	Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit nëpërmjet 840 dekretiveve të ndryshme për shtetësinë shqipëtare, falje, dekorata e tituj nderi dhe shpallje ligjesh.	840	943	118%
2	Të bëhen të njohura vlerat kombëtare, synimet e politikës së jashtme të vendit në interes të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet realizimit të 25 shkëmbimeve të vizitave të Presidentit të Republikës.	25	25	100%
3	Të mbështesë e të nxisë vlerat kombëtare si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit nëpërmjet organizimit të 100 veprimtarive kryesore protokollare brenda vendit.	100	160	160%
4	Rikonstruksioni dhe mobilimi i sallës VIP	1	1	100%

Si përfundim përsa i përket realizimit të buxhetit konstatohet se, Institucioni i Presidentit ka bërë një punë të mirë duke realizuar buxhetin në masën 99.7% dhe ka arritur në fund të vitit një diferencë plan-fakt prej 603,633 lekë.

Totali i shpenzimeve Janar – Dhjetor 2015					
Artikulli	Emërtimi	Plan Janar-Dhjetor	Fakt Janar-Dhjetor	Diferenca Plant-Fakt	Realizimi %
6009999	Shpenzime personeli	94,682,153	94,381,728	300,425	99.7
6029999	Shpenzime të tjera	88,901,127	88,864,794	36,333	100
<b>nëntotal</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>183,583,280</b>	<b>183,246,522</b>	<b>336,758</b>	<b>99.8</b>
230	Kapitale të patrupëzuara	593,820	593,820	0	100
231	Kapitale të trupëzuara	10,406,180	10,139,305	266,875	97.4
<b>nëntotali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>11,000,000</b>	<b>10,733,125</b>	<b>266,875</b>	<b>97.6</b>
<b>Total</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>194,583,280</b>	<b>193,979,647</b>	<b>603,633</b>	<b>99.7</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Nga Drejtoria e Financës janë kryer rakordimet me institucionet vartëse si dhe me Ministrinë e Financave si për planin ashtu dhe për faktin brenda afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave “Për mbylljen e buxhetit të vitit 2015”.

Për vitin 2016.

Me ligjin nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Institucionit të Presidentit i janë akorduar fonde në shumën totale 202,194,000 lekë.

Krahasuar me fondet e çelura në fillim viti, rezulton se ky institucion për vitin 2016 ka pasur ndryshime në fondet buxhetore me Akte Normativesi dhe me kërkesë të vet institucionit.

Bashkëlidhur projektbuxhetit janë vendosur dhe formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Në fakt projektbuxheti i Institucionit është dërguar dhe mbrojtur në Ministrinë e Financave në masën e nevojave të tij, si dhe akordimi ka qenë në referencë të taveve dhe limiteve të vendosura dhe miratuara nga Këshilli i Ministrave referuar PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm).

Me shkresën nr. 2242 prot, datë 28.12.2015 është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente për vitin 2016, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr 17761/91 prot, datë 07/01/2016 si dhe detajimi i buxhetit për investime miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr.498/1 prot, datë 26.01.2016.

Institucioni i Presidentit gëzon statusin e institucionit plotësisht buxhetor. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit.

Buxheti vjetor për 2016, i planifikuar për këto artikuj, në masën 99.3% ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti planifikuar vjetor, pas rishikimit ishte në masën e 202,194,000 lekë dhe realizimi faktik është në masën e 200,876,092 lekë, si më poshtë:

Nëlekë

Buxheti fillestar	Nr.llog	PBA kërkesa e institucionit		Buxheti fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi faktik	Përqindja e realizimit ndaj planit
		Faza e parë	Faza e dytë				
Pagat	600	85,000,000	85,000,000	85,000,000	83,500,000	83,261,657	99,7%
Kontrib.e sig shoqërore e shendet	601	15,000,000	15,000,000	15,000,000	11,800,000	11,731,450	99,4%
Mallra dhe shërbime	602	77,000,000	87,000,000	87,000,000	101,470,000	101,467,122	99,9%
Transfer.korrente të huaja	605			0	0	0	
Transferta për buxhete familje& individ.	606				200,000	200,000	100%
Shpenzime kapitale të trupëzuara	231	5,000,000	15,000,000	15,000,000	5,000,000	4,001,591	80%
Shpenzime kapitale tëpatrupëzuara	230				224,000	214,272	95%
<b>Totali</b>		<b>182,000,000</b>	<b>202,000,000</b>	<b>202,000,000</b>	<b>202,194,000</b>	<b>200,876,092</b>	<b>99%</b>
<b>Jashtë buxhetore</b>					<b>105,460</b>		
<b>Total + jashtë buxhetore</b>					<b>202,299,460</b>		

Konstatohet se rreth 41% të totalit të buxhetit të realizuar gjatë 2016 e zënë shpenzimet për “Paga”, 6% e zënë shpenzimet për “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, 51% “Shpenzime për mallra

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

dhe shërbime” dhe 2% “Shpenzimet kapitale të trupëzuara ” dhe pjesa tjetër llogarive zë një peshë shumë më të vogël, konkretisht:

“Transferta korrente të huaja” zë 0.1% të totalit të buxhetit dhe “shpenzime kapitale të patrupëzuara” zënë 0.1%.

Realizimi i buxhetit, në të gjitha programet e Institucionit, vlerësohet si relativisht i mirë, duke paraqitur një performancë të mirë në realizimin e shpenzimeve, gjykuar nga realizimi i tyre në vlerë dhe përqindje. Konkretisht përqindja e realizimit të buxhetit faktit me 99% detajuar në realizimet respektive të secilit artikull janë si vijon: artikulli 606 “Transferta për buxhete familje dhe individë” ka dhe nivelin e realizimit më të lart me 100%, pas tij vijon artikulli 602 “Mallra dhe shërbime” me një realizim prej 99,9% ndaj planit, më pas është artikulli 600 “Paga” me 99,7% , vijohet me llogarinë “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetësore” me një nivel realizimi prej 99,4%; llogaria “shpenzime kapitale të patrupëzuara” e cila është realizuar në nivelin 95% dhe në fund llogaria shpenzime kapitale të trupëzuara me nivel realizimi më të ulët prej 80%.

Në vitin 2016 konstatohen ndryshime të realizuara mbi buxhetin, që kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve me Akte Normative si dhe pas kërkesave të vet institucionit, si më poshtë vijon:

VITI 2016		Në mijë lekë
Art.		Ndryshime
<b>E M E R T I M I I PROGRAMIT</b>		
<b>600</b>	<b>Paga</b>	<b>-1,500,000</b>
		-1,500,000
<b>601</b>	<b>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</b>	<b>-3,200,000</b>
		-3,200,000
<b>602</b>	<b>Shpenzime Operative</b>	<b>14,470,000</b>
		9,770,000
<b>606</b>	<b>Trans per Buxhete Familjare &amp; Individ</b>	<b>200,000</b>
		30,000
		140,000
		30,000
<b>231</b>	<b>Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara</b>	<b>-9,776</b>
		-10,000
		224

Përsa i përket detajimit të shkresave përkatëse për ndryshimet e kryera gjatë gjatë vitit buxhetor:

Artikuj		600	601	602	606	231
	Shkresa e Institucionit					
	Ministria e Fincancës					
	480	4.03.2016	3302/1	10.03.2016		30,000
Akt Normativ nr.1, 29.07.2016	1584/1	5.08.2016	10739/54	12.08.2016		9,770,000
	1888	4.10.2016	13499/1	17.10.2016	-1,500,000	-3,200,000
	1936/1	7.10.2016	13720/1	13.10.2016		140,000
	2328/1	7.12.2016	16969/1	30.12.2016		30,000

Për vitin 2016 u konstatua se përveç ndryshimeve të kryera në zbatim të Aktit Normativ Nr.1 datë 29.07.2016 ndryshimet e tjera kanë ardhur si rrjedhojë e nevojës së rishikimit të objektivave duke i dhënë prioritet realizimit sa më të mirë të qëllimit të politikës së vet Institucionit.

Po ashtu u konstatua se në dokumentacion ishin prezent formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Referuar realizimit të produkteve raportuar në raportin e monitorimit dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.343 prot, datë 16.02.2017

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Përsa i përket raportit përmbledhës të realizimit të treguesve të performancës së produkteve të institucionit:

Emërtimi i treguesit të performancës	Njësia matëse	Plani fillestar			Plani I rishikuar			Fakti		
		Sasia	Kosto për njësi	Shpenzime	Sasia	Kosto për njësi	Shpenzime	Sasia	Kosto për njësi	Shpenzime
Dekrete për shtetësinë shqiptare, dekorata e tituj nderi	Numër dekretesh	250	217	54,230	270	212	57,230	422	136	57,230
Pritje dhe udhëtime të presidentit brenda e jashtë vendit	Numër vizitash	26	2,517	65,450	26	70,220	2,701	26	2,689	69,910
Veprimtari protokollare brenda vendit	numër aktivitete sh	155	434	67,320	155	447	69,320	156	444	69,320

Analiza e realizimit të objektivave të politikës së programit

**Objektivi 1:**

Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit nëpërmjet 250 dekretive të ndryshme për shtetësinë shqiptare, falje, dekorata e tituj nderi dhe shpallje ligjesh.

Ky objektivi është përmbushur në masën 100% dhe produkti është realizuar plotësisht, madje ka tejkalin me 69%.

**Objektivi 2:**

Të bëhen të njohura vlerat kombëtare, synimet e politikës së jashtme të vendit në interes të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet realizimit të 26 shkëmbimeve të vizitave të Presidentit të Republikës.

Ky objektivi është përmbushur në masën 100% dhe produkti është realizuar plotësisht në masën 100%.

**Objektivi 3:**

Të mbështesë e të nxisë vlerat kombëtare si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit nëpërmjet organizimit të 155 veprimtarive kryesore protokollare brenda vendit.

Ky objektivi është nuk është përmbushur pasi fondet e dhëna u alokuan në shpenzime operative, si rrjedhojë e domosdoshmërisë së realizimit të objektivave të tjera të lidhura me këto shpenzime. Produkti është realizuar plotësisht në masën 101%.

**Objektivi 4:**

Rikonstruksioni dhe mobilimi i zyrës së Presidentit.

Ky objektivi nuk është përmbushur pasi janë shkurtuar fondet për të, por u realizua projekt preventivi i tij në masën 100%.

**Objektivi 5:**

Rikonstruksioni dhe mobilimi i sallës së takimit kokë më kokë.

Ky objektivi është nuk është përmbushur pasi fondet e dhëna u alokuan në shpenzime operative, si rrjedhojë e domosdoshmërisë së realizimit të objektivave të tjera të lidhura me këto shpenzime.

**Objektivi 6:**

Përmirësimi i punës së punonjësve nëpërmjet blerjes së 48 pajisjeve kompjuterike.

Ky objektivi është përmbushur në masën 100% dhe produkti është realizuar plotësisht në masën 100%, si më poshtë vijon:

Objektivat e politikës	Niveli fillestar i	Niveli i rishikuar	Niveli faktik	% e realizimit të treguesit të
------------------------	--------------------	--------------------	---------------	--------------------------------



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

		planifikuar			performancës
1	Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit nëpërmjet 250 dekretimeve të ndryshme për shtetësinë shqipëtare, falje, dekorata e tituj nderi dhe shpallje ligjesh.	250	250	422	169%
2	Të bëhen të njohura vlerat kombëtare, synimet e politikës së jashtme të vendit në interes të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet realizimit të 26 shkëmbimeve të vizitave të Presidentit të Republikës.	26	26	26	100%
3	Të mbështesë e të nxisë vlerat kombëtare si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e shtetit nëpërmjet organizimit të 155 veprimtarive kryesore protokollare brenda vendit.	155	155	156	100%
4	Rikonstruksioni dhe mobilimi i zyrës së Presidentit.				
a)	<i>Zyrë e rikonstruktuar dhe mobiluar</i>	1	0	0	0
b)	<i>Projektprventiv</i>	0	1	1	100%
5	Rikonstruksioni dhe mobilimi i sallës së takimit kokë më kokë.	1	0	0	0
6	Përmirësim i punës së punonjësve nëpërmjet blerjes së 48 pajisjeve kompjuterike.	48	42	42	100%

#### Përsa i përket projekteve me investim të brendshëm

*Në '000 lekë*

Emërtimi i projektit	Kohëzgjatja e projektit	Buxheti i kontraktuar 2016	Plan buxheti i vitit 2016	Realizimi për periudhën e raportuar	Analizë
Blerje pajisjeve kompjuterike.	2016-2018	5,000	5,000	4,002	Realizuar plotësisht
Rikonstruksion i zyrës së Presidentit	2016-2016	0	0	0	Pakësim i fondit me Akt Normativ nr.1, datë 29.07.2016
Rikonstruksioni sallës së takimit kokë më kokë	2016-2016	0	0	0	Pakësim i fondit me Akt Normativ nr.1, datë 29.07.2016
Hartimi i Projektprventivit	2016-2016	224	224	214	Realizuar

Si përfundim në lidhje me realizimit e veprimtarisë së Institucionit të Presidentit për vitin 2016 mund të themi se janë realizuar plotësisht objektivat e parashikuara në fillim të vitit, si:

- Ushtrimi i funksioneve kushtetuese të Presidentit nëpërmjet dekretimeve të ndryshme për shtetësinë shqipëtare, falje, dekorata e tituj nderi dhe shpallje ligjesh.
- Njohja e vlerave kombëtare, synimet e politikës së jashtme të vendit, nëpërmjet shkëmbimit të vizitave të Presidentit të Republikës dhe pritjes së personaliteteve të larta shtetërore
- Mbështetja e nxitja e vlerave kombëtare, si element thelbësor që ndikon në zhvillimin e vendit , nëpërmjet organizimit të veprimtarive protokollare brenda vendit.

*Nga auditimi u konstatua se realizimi i objektivave u shoqërua me realizimin e produkteve në sasi dhe vlerë, duke shfrytëzuar plotësisht fondet përkatëse të planifikuara për to.*

Po ashtu u konstatua nga auditimi se, nga Drejtoria e Financës janë kryer rakordimet me institucionet vartëse si dhe me Ministrinë e Financave si për planin ashtu dhe për faktin brenda afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave “Për mbylljen e buxhetit të vitit 2016”.

Për vitin 2017.

Me ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Institucionit të Presidentit i janë akorduar fonde në shumën totale 211,000,000 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Për katër mujorin e parë 2017 krahasuar me fondet e çelura në fillim viti, rezulton se ky institucion nuk ka pasur ndryshime në fondet buxhetore.

Bashkëlidhur projektbuxhetit janë vendosur dhe formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Në fakt projektbuxheti i Institucionit është dërguar dhe mbrojtur në MF-ve në masën e nevojave të tij, po ashtu dhe akordimi ka qenë në referencë të tavaneve dhe limiteve të vendosura dhe miratuara nga Këshilli i Ministrave referuar PBA (Programit Buxhetor Afatmesëm).

Me shkresën nr.2430/1 prot, datë 05.01.2017 është dërguar detajimi i buxhetit për 2017, miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr.17911/71 prot, datë 10/01/2017, si dhe me shkresën nr.17911/289 datë 01.02.2017 është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale për vitin 2017.

Institucioni i Presidentit gëzon statusin e institucionit plotësisht buxhetor. Fondet e akorduara me ligj janë detajuar dhe miratuar nga strukturat përkatëse sipas afateve dhe kompetencave të ligjit. Është për t'u theksuar se totali i fondeve për investime në këtë institucion i çelur për vitin 2017 referuar ligjit të mësipërm është në vlerën 15,000,000 lekë ose në masën 7.1% të totalit të fondeve buxhetore. Për gjashtëmujorin e parë kemi dy realizime faktike të investimeve, blerje të dy automjeteve për administratën e Institucionit, me vlerë 6,906,000 lekë.

Në lekë

Buxheti fillestar	Nr.Ilog	PBA kërkesa e institucionit		Buxheti fillestar	Realizimi 6 mujor
		Faza e parë	Faza e dytë		
Pagat	600	85,000,000	85,000,000	84,000,000	43,762,546
Kontrib.e sig shoqërore e shendet	601	15,000,000	15,000,000	15,000,000	6,080,772
Mallra dhe shërbime	602	87,000,000	87,000,000	97,000,000	69,155,227
Transfer.korrente të huaja	605				
Transferta për buxhete familje & individ.	606				
Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara	231	5,000,000	5,000,000	15,000,000	6,906,000
<b>Totali</b>		<b>192,000,000</b>	<b>192,000,000</b>	<b>211,000,000</b>	<b>125,904,545</b>

Konstatohet se rreth 35% të totalit të buxhetit të realizuar gjatë 6 mujorit të parë të 2017 e zënë shpenzimet për “Paga”, rreth 5% e zënë shpenzimet për “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”, 5% e zënë shpenzimet për “Shpenzime për mallra dhe shërbime” dhe 5% janë “Shpenzimet kapitale të trupëzuara”.

Për vitin 2017 u konstatua se në dokumentacion ishin prezent formularët e investimeve aneksi 5/A dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit të investimit).

Një analizë krahasimore e realizimit të buxhetit për vitet e audituara

Institucioni i Presidentit, referuar misionit të vet dhe politikave të Qeverisë në vitet 2014, 2015 dhe 2016 ka planifikuar me rritje shpenzimet buxhetore. Plani përfundimtar dhe pesha specifike që zë çdo zë shpenzimi kundrejt totalit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

ART.	EMËRTIMI	VITE		
		2014	2015	2016
600	Paga	79,102,346	82,982,153	83,500,000
601	Sigurime Shoqërore	11,400,000	11,700,000	11,800,000
602	Mallra dhe shërbime	89,200,000	87,750,000	101,470,000
604	Transferta të brendsh.	280,000	942,413	
606	Trans. Buxhet Familjare	1,747,654	208,714	200,000
231	Shpenzimet Kapitale të trupëzuara	5,000,000	10,406,180	5,000,000





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

230	Shpenzimet kapitale të trupëzuara		593,820	224,000
<b>Totali</b>	<b>Korente+Kapitale</b>	<b>187,730,000</b>	<b>194,583,280</b>	<b>202,194,000</b>

Konstatohet një trend rritës për zërin paga (Ilogaria 600) dhe rrjedhimisht për sigurimet shoqërore (Ilogaria 601), e ndarë në periudha në vitin 2014 sikundër është analizuar në ndryshimet e ndodhura në buxhet është kryer një rialokim, për vitin 2015 ka patur largim të një punonjësi prej stafit dhe për vitin 2016 ka qenë fondi i parashikuar më lart për shkak edhe të numrit të plotë të punonjësve edhe për shkak se nuk është kryermë rialokim në këtë zë; zëri mallra (Ilogaria 602) ka trend rritës në vite kjo efekt i strategjisë së Institucionit për shkak të vet natyrës specifike që ka; zëri transferta të brendshme (Ilogaria 604) po ashtu rezulton me rritje për vitin 2014 – 2015, ndërsa për vitin 2015-2016 kjo Ilogari është 0 rrjedhojë kjo e për rrjedhojë e lëvizjes së stafik politik të Presidentit (Ilogaria 606) kjo Ilogari ka rënie, e cila i dedikohet faktit që fondi veçantë është prekur më pak sepse nuk ka patur raste fatkeqësish apo daljesh në pension; Ilogaria shpenzime kapitale të trupëzuara (230) dhe Ilogaria shpenzime kapitale të trupëzuara (230) për vitet 2014-2015 rezulton me rritje ndërsa 2015-2016 rezulton me rënie si rrjedhojë e programeve për investime të Institucionit.

Ndërsa përsa i përket realizimit që zë çdo zë shpenzimi kundrejt totalit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

ART.	EMËRTIMI	VITE		
		2014	2015	2016
600	Paga	1,499,586	1,428,622	1,293,721
601	Sigurime Shoqërore	246,955	236,107	214,615
602	Mallra dhe shërbime	1,326,647	1,629,965	1,917,447
604	Transferta të brendsh.		1,354	12,000
605	Transferta me jashtë	30,000	30,984	38,760
606	Trans. Buxhet Familjare	1,173,605	1,548,301	1,445,764
230	Shpenzime kapitale të trupëzuara	13,000	113,279	28,453
231	Shpenzimet kapitale të trupëzuara	2,361,574	3,230,981	5,925,560
	<b>Totali</b>	<b>6,651,367</b>	<b>8,219,593</b>	<b>10,876,320</b>

Ndërsa përsa i përket realizimit sikundër edhe vihet re prej tabelës së mësipërme shohim se realizimi është në të njëjtin trend me planin. Pra për sa më sipër ajo që na rezulton është se shpenzimet e Presidencës për tre vitet e fundit janë realizuar pothuajse në të njëjtat nivele, në masën 99% të planifikimit.

Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
Buxhet Plan	Buxhet Fakt	Buxhet Plan	Buxhet Fakt	Buxhet Plan	Buxhet Fakt
186,730,000	185,905,732	194,583,280	193,979,647	202,194,000	200,876,092
<i>Plan fillestar</i>	<i>Plan Perf.</i>	<i>Plan fillestar</i>	<i>Plan perf.</i>	<i>Plan fillestar</i>	<i>Plan perfund</i>
183,200,000	186,730,000	186,499,990	194,583,280	202,299,460	202,194,000

Si përfundim nga auditimi u konstatua se, buxheti faktik për të gjithë periudhën e marr në auditim, vitet 2014, 2015 dhe 2016 paraqitet më i ulët se plani përfundimtarë, dhe ka një nivel realizimi prej 99 % të faktit ndaj planit, çka dëshmon për një përdorim efektiv të fondeve buxhetore dhe shfrytëzim të plotë të tyre mbi bazë të nevojave realë të institucionit. Ndërsa diferencat mes planit fillestar dhe atij përfundimtarë për periudhën e marr në shqyrtim janë prezente për shkak të ndryshimeve të ndodhura me VKM, Akte Normative, nevoja të institucionit për shkak të daljeve në pension, sëmujëve, apo rasteve të fatkeqësive si dhe rialokime të ndodhura brenda për brenda zërave. Këto rialokime që janë realizuar gjatë viteve respektive buxhetore u konstatua se, janë kryer

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

si rrjedhojë e nevojës së rishikimit të objektivave duke i dhënë prioritet realizimit sa më të mirë të qëllimit të politikës së vet Institucionit.

Analiza e trendit të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2014, 2015, 2016 dhe gjashtë mujori 2017

*Në lekë*

Të ardhura	2014	2015	2016	6 mujori 2017
<b>Grant korrent i brendshëm:</b>	<b>171,403,767</b>	<b>191,637,902</b>	<b>205,935,665</b>	<b>126,166,172</b>
Nga i njëjti nivel qeverisje	156,581,246	169,339,461	174,527,248	118,998,545
Financim I pritshëm nga buxheti	13,847,061	22,132,981	31,302,957	7,062,167
Sponsorizime nga të tretë	975,460	105,460	105,460	105,460
<b>Të ardhura dytësore:</b>	<b>118,036</b>	<b>140,800</b>	<b>190,000</b>	<b>100,020</b>
<i>Nga ndërmarrjet e pronësia</i>	<i>116,500</i>	<i>139,800</i>	<i>190,000</i>	<i>100,020</i>
Tarifaadm dhe rregullatore	1,536	1,000		
<b>Total të ardhura</b>	<b>171,521,803</b>	<b>191,778,702</b>	<b>206,125,665</b>	<b>126,266,192</b>

Referuar tabelës së mësipërme, nga auditimi u konstatua se nga viti 2014 në 2015 përsa i përket të ardhurave nga granti i brendshëm korrent janë rritur me 2,024,135 lekë apo 12% dhe peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga i njëjti nivel qeverisje me 7% duke patur një shtim prej 12,758,215 lekë ndërsa përsa i përket të ardhurave dytësore ka një shtim me 22,764 lekë apo 19% ku peshën kryesore e zënë të ardhurat nga qeraja dhe kanë një rritje prej 23,300 lekë.

Për trendin nga viti 2015 në 2016 konstatohet se të ardhurat nga granti i brendshëm korrent janë shtuar me 14,487,763 lekë apo 8% dhe peshën kryesore e zë financimi nga buxheti i shtetit me një shtim prej 9,169,976 lekë, ndërsa përsa i përket të ardhurave dytësore ka një shtim me 50,200 lekë dhe peshën kryesore e zënë të ardhurat nga qeraja, 20% të totalit, dhe kanë një rritje prej 23,300 lekë.

*Të ardhurat dytësore përbëhen prej të ardhurave nga qeraja e lokalit, tarifës rregullatore dhe administrative dhe sponsorizimeve, të cilat në fakt janë regjistruar nën llogarinë "Grant i brendshëm korrent"*

Nga këto të ardhura nisur nga aktrakordimi mujor i të ardhurave me thesarin konstatohet se:

*Në lekë*

Përshkrimi	Titulli i arkëtuar	Pjesa e Institucionit	Pjesa e buxhetit
Të ardhura nga qeratë	116,500.00		116,500.00
Të ardhura nga licensat	136.10		136.10
Të ardhura nga gjobat	800.00		800.00
Kamatvonesa	600.00		600.00
Sponsorizime	209,460.00	209,460.00	
<b>Total</b>	<b>327,496.10</b>	<b>209,460.00</b>	<b>118,036.10</b>

Përveç sponsorizimit i cili është dhënë për efekt të një aktiviteti të organizuar prej Institucionit, pjesa tjetër ka kaluar në buxhet të Shtetit.

Të ardhurat e viteve ushtrimore 2014, 2015, 2016 dhe 6 mujori 2017 janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e viteve respektive, si dhe shpenzimet e ngelura palikujduar të muajt dhjetor të vitit paraardhës respektiv për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, si mëposhtë:

*Në lekë*

Shpenzime shfrytëzimi	2014	2015	2016	2017
Paga (600)	79,353,908	82,596,936	83,405,338	43,762,546
Sigurime shoq & shëndetësore (601)	11,364,687	11,603,607	11,750,330	6,080,772
Mallradhe shërbime (602)	78,723,074	96,212,639	110,474,537	69,155,227
Transferime korrente të brendshme (604)	280,000	942,413	0	0
Transferime për buxhet. Familjarë dhe individë (606)	1,576,638	176,847	200,000	0
<b>Total</b>	<b>171,298,307</b>	<b>191,532,442</b>	<b>205,830,205</b>	<b>118,998,545</b>

Te llogaria 606 "Transferime për buxhet. familjarë dhe individë" janë përfshirë shpenzimet e dhëna në mbështetje të VKM nr.838 datë 21.10.2010 "Për krijim dhe përdorimin e Fondit të Veçantë". Nga auditimi u konstatua se për vitin 2015 nuk ka asnjë rast të përdorimit të këtij fondi, për vitin 2014 janë 4 të tilla ( 3 raste ndihme ekonomike dhe një sëmundje) dhe për vitin 2016 janë 3 raste ( dy raste ndihme ekonomike dhe një pension).

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Për të tre vitet e audituara konstatohet se diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat analizohen si më poshtë:

Nëlekë

Përshkrimi	2014	2015	2016
Të ardhura të shfrytëzimit	171,521,803	191,778,702	206,125,665
Shpenzime korrente	171,298,307	191,532,442	205,830,205
<b>Diferenca</b>	<b>223,496</b>	<b>246,260</b>	<b>295,460</b>
	<i>nga e cila:</i>	<i>nga e cila:</i>	<i>nga e cila:</i>
<i>Derdhje në buxhet e të ardhurave të papërdorura</i>	<i>118,036</i>	<i>190,000</i>	<i>140,800</i>
<i>Rezultat nga funksionimi</i>	<i>105,460</i>	<i>105,460</i>	<i>105,460</i>

Pra konstatohet se mes të ardhurave të shfrytëzimit dhe shpenzimeve korrente ka diferencë e cila në vite është shtuar dhe përbëhet nga: një shumë e papërdorur të ardhurash, e cila përfaqëson atë pjesë të të ardhurave që sipas dispozitave ligjore arkëtohet në Institucion, i përket institucionit për t'u përdorur deri në fund të vitit por nuk e ka përdorur. Në këtë rast kjo e ardhur i përket buxhetit të shtetit dhe në fund të periudhës i kalon atij. Gjithashtu dhe nga vlera të pasqyruara në llogarinë 85 "Rezultatet nga funksionimi" e cila përfaqëson rezultatin nga funksionimi që rrjedh nga të ardhurat që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t'u trashëguar në ushtrimet e mëpashme.

**5.2 Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave dytësore nga veprimtaria ekonomike bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.432, datë 28.6.2006 "Per krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".**

Institucioni i Presidentit të Republikës, bazuar në VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", për periudhën objekt auditimi (6 mujori II-2014, 2015, 2016, dhe gjashtë mujori 2017) ka realizuar të ardhura nga veprimtaria ekonomike në vlerën 468, 916 lekë, pasqyruar këto në tabelën më poshtë:

Në /lekë

Nr.	Emërtimi	Të ardhura gjithsej	Nga qiratë	Tarifa admin.dhe rregullatore	Nga shitja e mall.e shërb.	Të tjera Sponsoriz.
1.	Viti 2014 (gjashtë mujori i II)	71,436	69,900	1,536	-	-
2.	Viti 2015	140,800	139,800	1,000	-	-
3.	Viti 2016	190,000	190,000	-	-	-
4.	Viti 2017 (katër mujori)	66,680	66,680	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>468,916</b>	<b>466,380</b>	<b>2,536</b>	-	-

Nisur nga treguesit e mesipërm rezultojn se, për periudhën objekt auditimi, peshën specifike më të madhe të të ardhurave e zënë të ardhurat e realizuara nga zëri "qera" pasi për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2014 janë realizuar 69. 9 mijë lekë ose 97.8 % e të ardhurave gjithësej, ndërsa për vitin 2015 janë realizuar 139.8 mijë lekë ose 99.2 % e të ardhurave gjithësej.Në këtë periudhë janë krijuar të ardhura me vlerë 2,536 lekë nga tarifa e administrimit, të derdhura gabimisht nga subjekte private.

Për vitin 2016 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 të ardhurat dytësore nga veprimtaria ekonomike e institucionit janë krijuar vetëm nga qeratë, përkatësisht në vlerën 190 mijë lekë për vitin 2016 dhe 66.68 mijë lekë për katër mujorin e parë të vitit 2017.

Të ardhurat e krijuara nga "qiratë" janë rezultat i dhënies me qira të një ambienti brenda institucionit me sipërfaqe 50.4 m2 së bashku me pajisjet, me destinacion Bar-Kafe, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.6.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", pika /b, dhe konkretisht:

Për vitin 2014, Institucioni i Presidentit ka lidhur kontratë qiraje nr.11/4, datë 03.02.2014, për vitin 2015 kontratën nr. 35/4, datë 04.02.2015 me objekt "Dhënien me qira të një ambienti" me sipërfaqe



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

50,4 m<sup>2</sup>, me afat 1 vjeçar, në vlerën 11,650 lekë/ muaj (përfshirë dhe vlerën e orendive sipas inventarit), konform kreu 2, neni 7 pika a të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënjes me qera të pasurisë shtetërore”. Vlera e qirasë likujduar nga qiramarrësi dhe përfituar të “ardhura” për qiradhënësin në 6 mujorin e dytë 2014 është në 69,900 lekë dhe për vitin 2015 është në vlerën 139,800 lekë.

Për vitin 2016 dhe 2017, Institucioni i Presidentit ka lidhur kontratë qiraje nr. 25, datë 03.02.2014, dhe nr. 212/2, datë 03.02.2017 me objekt “dhënie me qira të një ambienti” me sipërfaqe 50,4 m<sup>2</sup>, me afat 1 vjeçar, në vlerën 16,670 lekë/ muaj (përfshirë dhe vlerën e orendive sipas inventarit), konform kreu 1, pika 6 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënjes me qera, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Vlera e qirasë likujduar nga qiramarrësi dhe përfituar të “ardhura” për qiradhënësin në vitin 2016 është në 190,000 lekë dhe për katërmujorin e parë të vitit 2017 është në vlerën 66,680 lekë.

Konstatohet se, në kontratën vjetore të lidhur midis palëve, për cdo vit kalendarik, në nenin 7 “Të drejtat dhe detyrimet e qerramarrësit”, nuk është përcaktuar pagesa e shpenzimeve që do të kryejë qiramarrësi për energjinë elektrike dhe ujine konsumuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit si Bar-Kafe. Në nenin 4 “vlera e kontratës”, përcaktohet vlera e kontratës 16,670 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj, e përbërë nga:

- vlera e qerasë së ambientit 50,4 m<sup>2</sup>, në vlerën 15,120 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë) lekë;

- vlera e qerasë, për përdorimin e inventarit të pajisjeve, në vlerën 1,550 lekë (njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë).

*Qiramarrësit, në kontratë nuk i është përcaktuar për likuidim detyrimet për ujë dhe energjinë elektrike të konsumuar.*

Bashkangjitur kontratës për cdo vit kalendarik, ndodhet i gjithë dokumentacioni sipas kritereve të përcaktuar në vendimet e sipërcituar.

Në periudhën objekt auditimi në Institucionin e Presidentit nuk janë krijuar të ardhura nga aktivitete të tjera.

Të gjitha të ardhurat e krijuara nga veprimtaria ekonomike për periudhën objekt auditimi, janë derdhur në buxhetin e shtetit.

## **A. OPINIONI I AUDITUESVE:**

***Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200<sup>1</sup>) e shpenzimeve:***

Nga auditimi mbi përputhshmërinë<sup>2</sup>, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti – Institucioni i Presidentit të Republikës, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatua:

*Institucioni i Presidentit të Republikës ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko- financiare të institucionit, ka administruar përgjithësisht drejt vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion, bazuar në rregullat buxhetore.*

<sup>1</sup> **ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

**ISSAI 4200** - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare

2 Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-it”.



*Raportimet financiare paraqesin drejt veprimtarinë ekonomiko financiare të institucionit dhe i kanë dhënë menaxherit të lartë të gjithë informacionin e nevojshëm për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit ka funksionuar përgjithësisht drejt, evidentohet nevoja për përmirësime, sidomos në drejtim të forcimit të rregullaritetit financiar, të trajtuar sipas gjetjeve nga auditimi.*

**Konkluzion/Opinion:**

*Nga auditimi i ligjshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Institucioni i Presidentit të Republikës, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinioni të pakualifikuar**.*

**GJETJE DHE REKOMANDIME**

1. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për periudhën e viteve objekt auditimi (vitet 2014, 2015 dhe 2016) u konstatua se, sektori i financës, gjatë periudhës së auditimit nuk kishte të përfunduar zyrtarizimin e regjistrit analitik të aktiveve sipas formatit zyrtar, në formë analitike, në përputhje me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

Pavarësisht kësaj të gjitha dhuratat për Institucionin e Presidentit, dhe/ose dhuruar nga Institucioni i Presidentit, janë dokumentuar saktë dhe drejtë.

**Rekomandim:**

Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së Institucionit, të caktojë Nëpunësin Zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të aktiveve. Regjistri i aktiveve të njësisë, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë. Sektori i financës duhet të përfundojë zyrtarizimin e këtij regjistri i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike. Ky regjistër duhet të krijohet dhe përditësohet në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë E Sektorit Publik”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014 dhe nr.11, datë 06.05.2016.

2. Në pasqyrat financiare për vitet 2014, 2015, 2016, mungonte formati 10 “Shënime shpjeguese”. Referuar SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, shënimet shpjeguese japin një përshkrim ose zbrëthim të mëtejshëm të zërave të paraqitur në këto pasqyra, si dhe informacion mbi zërat që nuk plotësojnë kriteret për një paraqitje të veçantë në pasqyrat financiare. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike raportuese duhet të japi informacionin, duke u bazuar në konceptin e materialitetit dhe zërat jomaterialë që mund të paraqiten të grupuar.





**Rekomandim:**

Bazuar në kërkesat e Udhëzimit nr. 26 datë 27.12.2007 për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit, zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj” ku përcaktohen përbërësit dhe formatet e pasqyrave financiare duhet të shtohet edhe formati nr.10 pytësor me të dhëna e shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare në pasqyrat financiare të Institucionit.

3. Në gjendjen e inventarëve të Institucionit për vitet 2015 dhe 2016, konstatohet se pjesë e këtyre inventareve ishin dhe materiale shumë të konsumuara apo dëmtuara, për të cilat kosto e mbajtjes rezulton më e lartë se përfitimi nga përdorimi, të cilat janë vlerësuar mallra për nxjerrje jashtë përdorimit. Mbajtja e aktiveve të konsumuara dhe të papërdorshme nga ana e subjektit bën që Pasqyrat Financiare të mos paraqesin gjendjen reale, çka bie ndesh me parimet e hartimit të Pasqyrave Financiare.

Praktika e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit ka filluar të zbatohet në vitin 2017. Me Urdhrin nr.263 prot, datë 07.02.2017 është krijuar komisioni për vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe me Urdhërin nr.264 prot, datë 07.02.2017 është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre aktiveve. Nga auditimi rezultoi se procesverbali i vlerësimit të aktiveve nuk është firmosur nga nënpunësi autorizues, në kundërshtim me pikën 105 të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rekomandim:**

Institucioni duhet të operojë mbështetur në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.20 datë 17.11.2014 dhe nr.11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, duhet të asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose djegur, në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit 30. Dhe në zbatim të pikës 122 d) duhet lënë gjurmë për këtë proces.

Megjithëse, kjo praktikë e nxjerrjes jashtë përdorimit ka filluar të zbatohet në vitin 2017 gjykojmë të arsyeshme rekomandimin që kjo praktik të gjej përdorim çdo vit kur është e nevojshme, në mënyrë të tillë që Institucioni të mos ketë gjendje në inventarët e vet materiale të konsumuara apo dëmtuara të cilat nuk shërbejnë më për aktivitetin e tij dhe që kosto e mbajtjes së tyre rezulton më e lartë nga përfitimi prej përdorimit të tyre, si dhe të jetë e gjitha në përputhje me Udhëzimin 30, datë 27.12.2011.

4. Nga auditimi i kryer mbi pasqyrat financiare të Institucionit të Presidentit të Republikës, konstatohet se lidhur me procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së llogarive, përmbajtjes dhe plotësimit të pasqyrave financiare është operuar në përputhje Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14 datë 28/12/2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit e zbatimit të projekteve e marrveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26 datë 27.12.2007. Por përse i përket formatit 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” konstatohen disa anomali jomateriale, në hartimin e tij. Formatit 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet” klasa II. Llogaria “Shpenzime për investime” duhet të rakordojë me formatin 6 “gjendje dhe ndryshim i aktiveve të qendrueshme të trupëzuara” .



**Rekomandim:**

Plotësimi i kësaj pasqyre duhet kryer në përputhje me pikat 5. Shpenzimet e lidhura me investimet sipas së cilës ky format duhet plotësuar me tepricën e këtyre llogarive në çelje të vitit ushtrimor e cila duhet të jetë respektivisht sa çelja e këtyre llogarive në bilanc, debitimet lidhur me transaksionet e vitit ku pasqyrohen veprimet e vitit për shtesat, kreditimet lidhur me transaksionet e vitit ku pasqyrohen veprimet e vitit për paksimet dhe tepricën në fund të vitit ushtrimor. Të ardhurat e lidhura me investimet sipas së cilës ky format duhet plotësuar me tepricën e këtyre llogarive në çelje të vitit ushtrimor e cila duhet të jetë respektivisht sa çelja e këtyre llogarive në bilanc, debitimet lidhur me transaksionet e vitit ku pasqyrohen veprimet e vitit për paksimet, kreditimet lidhur me transaksionet e vitit ku pasqyrohen veprimet e vitit për shtesat dhe tepricën në fund të vitit ushtrimor të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14 datë 28.12.2006.

5. Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) është ngritur me urdhër nr.880 datë 31.03.2017. Ekipit i Menaxhimit të Programeve (EMP), është ngritur për vitin 2014 me Urdhërin nr. 11, datë 07.04.2014, për vitin 2015 dhe 2016 me Urdhërin nr. 6, datë 16.04.2015 dhe për vitin 2017 me Urdhërin nr. 881, datë 31.04.2017. Për këtë periudhë nuk është operuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012 dhe nr. 22, datë 17.11.2016, ku theksohet rëndësia e EMP, ashtu sikundër dhe e GMS, në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor me qëllim realizimin e objektivave të synuara, të produkteve të parashikuara si dhe për përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit.

**Rekomandim:**

Një buxhet i besueshëm është ai që ekzekutohet brenda kufijve të planifikuar, ku publiku bindet arsyeshëm se ndërtimi i tij është bazuar mbi nevojat e qytetarëve dhe politika fiskale mbështetëse. Në këto kushte ai konvertohet në një instrument efektiv dhe eficient i kërkesës së llogaridhënies së qeverisë. Çdo “kërcënim” i mundshëm mbi realizimin e tij cënon mundësinë e shtetit për realizimin e strategjive dhe objektivave të planifikuara. Sa më sipër rekomandohet pjesëmarrja e GMS dhe EMP në procesin e analizës së nevojave të institucionit gjatë fazës së hartimit të buxhetit, monitorimit dhe zbatimit të tij, si dhe analizës së nevojave.

E gjithë kjo veprimtari të kryhet në përputhje me Udhëzimet nr.8 datë 29.03.2012 dhe nr. 22 datë 17.11.2016 të Ministrisë së Financave.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË  
REPUBLIKËS